



TË CERTIFIKUARIT NGA QENDRAT E FORMIMIT PROFESIONAL 2024
GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:





TË CERTIFIKUARIT NGA QENDRAT E FORMIMIT PROFESIONAL **2024**
GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR



TË CERTIFIKUARIT NGA QENDRAT E FORMIMIT PROFESIONAL 2024: GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR

Ky publikim është realizuar në bashkëpunim midis Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) dhe projektit “Aftësi për Punë” (S4J).

Raporti u përgatit nga Blerina Metanj PhD, konsulente dhe Assoc. Prof. Ines Nurja, konsulente për metodologjinë, nën mbikëqyrjen e Menaxheres për Qëndrueshmërinë të Projektit, Aleka Papa.

Rreth projektit “Aftësi për Punë”

“Aftësi për Punë” (S4J), është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact.

Shënim: Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim, nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

TABELA E PËRMBAJTJES

PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
1. HYRJE	9
2. METODOLOGJIA	11
2.1 Qasja metodologjike	11
2.2 Instrumenti i studimit - pyetësoni	11
2.3 Analizimi i të dhënave	12
2.4 Kufizimet metodologjike	13
3. PËRSHKRIMI I DEMOGRAFISË	14
3.1 Profili gjinor	15
3.2 Profili moshor	15
3.3 Profili sipas qendrave	16
3.4 Niveli arsimor	16
3.5 Statusi i punësimit para kursit	17
3.6 Përkatësia etnike dhe aftësia e kufizuar	17
4. SITUATA E PUNËSIMIT E TË CERTIFIKUARVE	19
5. TË CERTIFIKUARIT E PUNËSUAR	21
5.1 Karakteristikat kryesore në punën aktuale	23
5.2 Integrimi në tregun e punës – të ardhurat	26
5.3 Përputhshmëria e trajnimit	27
5.4 Të certifikuarit e vetëpunësuar	30
6. TË CERTIFIKUARIT E PAPUNË	33
6.1 Punësimi i mëparshëm	34
6.2 Të kërkuarit për punë	35
6.3 Marrëdhënia me zyrat e punës	36
7. TË CERTIFIKUARIT JOAKTIV NË TREGUN E PUNËS	38
7.1 Student/Kursant në trajnime të mëtejshme	39
8. VLERËSIMI RETROSPEKTIV I TË CERTIFIKUARVE	41
8.1 Orientimi dhe këshillimi i qendrave të formimit	43
8.2 Pritshmëritë për të ardhmen e afërt	44
9. KONKLUZIONE	46
ANEKS: REZULTATET SIPAS QENDRAVE	49

Lista e tabelave

Tabela 1. Pjesëmarrja sipas qendrave për vitin 2024	14
Tabela 2. Shpërndarja sipas gjinisë	15
Tabela 3. Shpërndarja sipas grup moshës	15
Tabela 4. Shpërndarja e të certifikuarve dhe anketuarve sipas qendrave	16
Tabela 5. Të certifikuarit dhe të anketuarit sipas nivelit arsimor	17
Tabela 6. Statusi i punësimit i popullatës së të certifikuarve para kursit	17
Tabela 7. Shpërndarja e të anketuarve sipas përkatësisë etnike	18
Tabela 8. Statusi i punësimit sipas kategorive dhe viteve të certifikimit	20
Tabela 9. Të punësuarit sipas qendrave dhe viteve të certifikimit	21
Tabela 10. Të punësuar sipas statusit të punësimit para kursit	22
Tabela 11. Situata e punësimit sipas përkatësisë etnike	22
Tabela 12. Kohëzgjatja në punën aktuale sipas viteve të certifikimit (2019-2024)	23
Tabela 13. Mënyra e gjetjes së punës sipas viteve të certifikimit (2019-2024)	24
Tabela 14. Madhësia e subjektit ku janë të punësuar të certifikuar (2020-2024)	26
Tabela 15. Qëndrueshmëria në punën aktuale (2020-2024)	26
Tabela 16. Të ardhurat nga puna (2019-2024)	26
Tabela 17. Perceptimi për të ardhurat (2019-2024)	27
Tabela 18. Arsyet e përzgjedhjes së një pune ndryshe nga ajo e trajnimit (2020-2024)	29
Tabela 19. Koha për hapjen e biznesit (2019-2024)	31
Tabela 20. Perspektiva e vetëpunësimit (2019-2024)	32
Tabela 21. Arsyet e largimit nga puna (2019-2024)	34
Tabela 23. Arsyet që nuk kërkon punë (2019-2024)	36
Tabela 24. Ndihma e zyrave të punës (2019-2024)	37
Tabela 25. Arsyet e mos regjistrimit (2019-2024)	37
Tabela 26. Arsyet e ndjekjes së kursit (2019-2024)	39
Tabela 27. Institucioni arsimor i studimit (2019-2024)	40
Tabela 28. Përqindja e të certifikuarve të cilët do e rizgjidhnin kursin, sipas qendrave (2019-2024)	41
Tabela 29. Vlerësimi i kursit të formimit profesional (2019-2020)	43
Tabela 30. Orientimi dhe këshillimi për të gjetur punë	44
Tabela 31. Pritshmëritë brenda dy viteve të ardhshme (2019-2024)	44

Lista e grafikëve

Graf. 1 Statusi aktual i punësimit (2019-2024)	20
Graf. 2 Të certifikuarit e punësuar sipas gjinisë (2019-2024)	22
Graf. 3 Punësimi në të njëjtin vend sipas viteve të certifikimi (2019-2024)	25
Graf. 4 Lloji i punësimit sipas viteve të studimit (2019-2024)	25
Graf. 5 Lidhja e kursit me punën aktuale (2019-2024)	27
Graf. 6 Lidhja e kursit me punën aktuale sipas qendrave	28
Graf. 7 Përdorimi i njohurive në punë aktuale (2019-2024)	29
Graf. 8 Shpërndarja e të vetëpunësuarve sipas qendrave 2024	30
Graf. 9 Lidhja e fushës së biznesit me trajnimin (2019-2024)	31
Graf. 10 Numri i të punësuarve në biznesin privat/familjar (2019-2024)	32
Graf. 11 Të certifikuarit e papunë (2019-2024)	33
Graf. 12 Të certifikuarit e papunë sipas qendrave	33
Graf. 13 Punësimi i mëparshëm për të papunët (2019-2024)	34
Graf. 14 Kërkimi i një pune 4 javët e fundit (2019-2020)	35
Graf. 15 Regjistrimi në zyrat e punës për të papunët (2019-2024)	37
Graf. 16 Inaktivët sipas qendrave, 2024	38
Graf. 17 Punësimi i mëparshëm për inaktivët (2019-2024)	39
Graf. 18 Lidhja e studimeve me kursin (2019-2024)	40
Graf. 19 Rizgjedhja e kursit (2019-2024)	41
Graf. 20 Vlerësimi i kursit profesional 2024	42

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport paraqet gjetjet e studimit kombëtar mbi gjurmimin e të certifikuarve nga qendrat e formimit profesional gjatë vitit 2024. Ky është studimi i pestë i këtij lloji: i pari u realizua për vitin 2019, i dyti për vitin 2021, i treti për vitin 2022, i katërti për vitin 2023, ndërsa i fundit mbulon vitin 2024.

Raporti nuk kufizohet vetëm në paraqitjen e të dhënave të vitit 2024, por integron gjithashtu rezultatet e studimeve të mëparshme, me synimin për të ofruar një panoramë të zhvillimeve dhe trendeve kryesore që karakterizojnë gjendjen e të certifikuarve gjatë periudhës 2019-2024.

Të dhëna demografike për të certifikuarit e anketuar

Gjatë vitit 2024 u certifikuan 6876 persona në kurse profesionale, nga ku në studim morën pjesë rreth 2671, me një pjesëmarrje rreth 38.8%. Përbërja e kampionit është në përputhje me strukturën e popullatës së të gjithë të certifikuarve të vitit 2024, ku 51.9% janë femra dhe 48.1% meshkuj. Mosha mesatare e të certifikuarve pjesëmarrës në studim rezulton 33.9 vjeç, ndërsa 60.6% e tyre kanë arsim të mesëm të përgjithshëm ose profesional. Vetëm 1% e të anketuarve kanë deklaruar përkatësi etnike Rome ose Egjiptiane.

Të certifikuarit e punësuar

- 63.5% e të certifikuarve janë aktualisht të punësuar. Ky rezultat paraqet një rënie të lehtë prej 3.4 pikë përqindjeje në krahasim me vitin e kaluar. Shkalla e punësimit sipas gjinisë tregon se 72.9% e meshkujve të certifikuar janë të punësuar, krahasuar me 54.9% të femrave.
- Nivelet më të larta të punësimit regjistrohen në QFP Durrës (73%), QFP Vlorë (70.4%) dhe QFP Gjirokastrë (69.7%). Ndërkohë, nivelet më të ulëta evidentohen në Qendrën e Lëvizshme (41.9%), QFP Fier (55.3%) dhe QFP Korçë (58.6%).
- Punësimi përmes rrjeteve personale (familjarë, miq, të njohur) përbën 33.8%, duke shënuar një rënie të ndjeshme krahasuar me vitin e kaluar dhe duke ndjekur një trend rënës përgjatë viteve. Ky fakt tregon një orientim në rritje drejt formave më meritokratike të punësimit. Në këtë kuadër, përdorimi i aplikimeve të drejtpërdrejta (dëngimi i CV-së apo kontaktet direkte me punëdhënësin) ka arritur 31.6%, ndërsa përgjigjja ndaj shpalljeve publike (faqe interneti, media sociale etj.) përbën 22.5%. Ndërkohë 3.6% kanë gjetur punë nëpërmjet përdorimit të Zyrave të Punës, e cila shënon një rritje në krahasim me një vit më parë; rreth 1.7% nga praktika profesionale në biznes; 0.3% nga instruktorë të qendrës; 0.3% nga agjenci private të punësimit dhe 5.4% nga mënyra të tjera.
- Të certifikuarit e punësuar janë kryesisht të angazhuar në ndërmarrje mikro (deri në 9 punonjës) me 44.5%, ose në ndërmarrje të vogla me 35.5%, duke reflektuar edhe strukturën e përgjithshme të bizneseve aktive në vend gjatë vitit 2024. Punësimi në ndërmarrje të mesme me 50-249 punonjës përbën 15.4% të punësimit të të certifikuarve dhe 4.4% në ndërmarrje me më shumë se 250 punonjës.
- Më shumë se gjysma e të certifikuarve të punësuar, 55.5% deklarojnë se pas përfundimit të kursit të ardhurat e tyre kanë pësuar rritje.
- 50.2% e të certifikuarve të punësuar kanë raportuar se kursi i ndjekur lidhet drejtpërdrejt me punën e tyre aktuale. Edhe pse ky tregues ka pësuar një rënie krahasuar me një vit më parë, tendenca afatgjatë mbetet pozitive.
- 60.6% e të certifikuarve të punësuar deklarojnë se aplikojnë në punën e tyre aktuale njohuritë e përftuara gjatë kursit.

Të certifikuarit e papunë

- 12.1% e të certifikuarve rezultojnë të papunë. Analiza gjinore tregon se 14.7% e femrave të certifikuar janë të papuna, kundrejt 9.3% të meshkujve.
- Vetëm 25.9% e të papunëve kanë qenë më parë të punësuar, duke nënkuptuar se pjesa më e madhe e tyre ndodhen në papunësi afatgjatë, çka mund të vështirësojë integrimin në tregun e punës.
- 81% e të papunëve kanë deklaruar se kanë kërkuar punë gjatë katër javëve të fundit, duke dëshmuar një nivel të lartë aktivizimi në procesin e kërkimit të një pune.
- Përdorimi i Zyrës së Punës në procesin e kërkimit të punës ka shënuar një rritje të qëndrueshme gjatë periudhës së analizuar. Për të certifikuarit në vitin 2024, ky tregues arriti në 29.4%, nga 18.0% në vitin 2019, duke përfaqësuar nivelin më të lartë të regjistruar deri më tani.
- 63.9% e të papunëve të certifikuar ishin të regjistruar në Zyrat e Punës. Ky është niveli më i lartë i periudhës 2019-2024, duke përfaqësuar një rritje me mbi 14 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2019 (49.9%) dhe me 7.7 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2023 (56.2%).

Vlerësimi për kurset e formimit profesional

- Pothuajse tetë në dhjetë të certifikuar (76.8%) kanë deklaruar se do të rizgjidhnin kursin e ndjekur. Ky tregues mbetet i qëndrueshëm në të njëjtin nivel me një vit më parë.
- Aftësitë teorike dhe praktike të stafit (94.3%) dhe metodat e mësimdhënies (94.0%) kanë marrë vlerësimet më të larta, duke dëshmuar profesionalizmin dhe efektivitetin e instruktorëve. Po ashtu, kurrikulat (92.8%), praktika në qendër (92.5%) dhe materialet didaktike (92.4%) janë vlerësuar shumë pozitivisht, çka tregon një balancim të mirë ndërmjet përmbajtjes teorike dhe mbështetjes materiale.
- Infrastruktura (88.2%) dhe praktika në biznese (85.5%) kanë marrë vlerësime disi më të ulëta krahasuar me aspektet didaktike, duke sinjalizuar nevojën për përmirësimin e kushteve fizike dhe zgjerimin e mundësive të praktikave profesionale jashtë qendrave të formimit.

Pritshmëritë për të ardhmen

- 53.5% e të certifikuarve e lidhin të ardhmen e tyre me punësimin, 30.2% synojnë sipërmarrjen, 2.8% shprehen se duan të ndjekin studime të mëtejshme, ndërsa 7.4% planifikojnë migrim brenda ose jashtë vendit.



1. HYRJE

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të certifikuarit realizohet nëpërmjet ‘studimeve gjurmuese’ që ndjekin ose ‘gjurmojnë’ të certifikuarit pasi ata certifikohen nga qendra e formimit. Gjurmimi është një praktikë e konsoliduar dhe standarde në sektorin e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Evropë. Të dhënat nga studimet gjurmuese përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi relevancën e ofertës për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve ose kursantëve me njohuritë dhe aftësitë e duhura.

Në Shqipëri, në përputhje me ligjin nr.15/2017 ‘Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar dhe VKM nr. 554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, i ndryshuar është institucionalizuar gjurmimi në nivel kombëtar me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) përgjegjëse për kryerjen e studimeve për gjurmimin e të diplomuarve/certifikuarve të AFP-së. Ndërkohë, institucionet ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional (IoAFP) janë përgjegjëse nëpërmjet Njesisë së zhvillimit për gjurmimin në nivel ofruesi.

Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve dhe të certifikuarve të AFP në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv pas përfundimit të studimeve ose trajnimit. Ato përfaqësojnë një gaburim të rëndësishëm për vlerësimin dhe mbështetjen në përmirësimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së AFP me tregun e punës. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve/certifikuarve.

Në këtë kuadër, AKPA me mbështetjen e projektit “Aftësi për Punë” (S4J) ndërmon gjurmimin në nivel kombëtar të të certifikuarve të vitit 2024 nga qendrat e formimit profesional në Shqipëri me qëllimin e përgjithshëm të monitorimit të treguesve kryesorë të tregut të punës për të certifikuarit nga sistemi.

Objektivat specifike të gjurmimit në nivel kombëtar mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Vlerësimi i statusit të përgjithshëm të punësimit të të certifikuarve;
- Vlerësimi i diferencave në statusin e punësimit sipas gjinisë, grupmoshës, apo qendrës së formimit;
- Identifikimi i treguesve specifikë rreth integritit në tregun e punës për të certifikuarit pas mbarimit të kursit, si koha mesatare në gjetjen e punës, mënyrat e gjetjes së punës, profili i punës etj.
- Analizimi i të certifikuarve të punësuar, në lidhje me tipare si përputhja e kursit me vendin e punës, paga, kushtet e punës etj.
- Analizimi i të certifikuarve, që nuk janë ekonomikisht aktivë pas mbarimit të kursit;
- Vlerësimi i institucioneve ofruese bazuar në perceptimin retrospektiv të të certifikuarve;

38.8% e të certifikuarve nga 6876 të certifikuar në total prej qendrave publike të

formimit profesional, ju përgjigjën sondazhit të gjurmimit gjatë periudhës maj-qershor 2025. Ky raport përshkruan dhe analizon të dhënat dhe rezultatet e përgjithshme për rrugëtimin profesional të të certifikuarve pas mbarimit të kursit, integrimin e tyre në tregun e punës, si dhe aspekte të tjera që mund të ndihmojnë drejt vlerësimit të orientimit drejt tregut të sistemit të AFP-së në Shqipëri. Rezultatet kryesore janë paraqitur në përputhje me objektivat e studimit të gjurmimit.

Seksioni në vijim përshkruan metodologjinë e ndjekur për gjurmimin kombëtar. Më tej analizohen në detaj rezultatet për: a) kategorinë e të certifikuarve të punësuar, b) të certifikuarve të papunë, c) të certifikuarve joaktivë, si dhe d) perceptimet mbi vlerësimin e qendrave, bazuar në vlerësimin retrospektiv të të certifikuarve. Në seksionin përmbyllës, jepen rezultatet e përgjithshme dhe rekomandimet kryesore.

2. METODOLOGJIA

2.1 Qasja metodologjike

Për studimin kombëtar të gjurmimit të kursantëve të certifikuar u përdor një model hulumtimi i tërthortë, me mbledhje të dhënash përmes pyetësorëve të standardizuar. Procesi nisi në maj 2025 dhe përfshiu nishikimin e pyetësorit, trajnimin e anketuesve dhe realizimin e intervistave telefonike.

Popullata e studimit përbëhet nga personat e certifikuar në dhjetë qendrat publike të formimit profesional gjatë vitit 2024.

Ky nuk është studimi i parë për këtë grup target. Para vitit 2021, gjurmimi kryhej përmes një kampioni të përzgjedhur në bazë të numrit total të të certifikuarve. Në vitin 2021, për të mundësuar gjenerimin e indikatorëve të disagreguar sipas qendrës, grupit social dhe kursit, u vendos të realizohej censusi i popullatës në vend të kampionimit. Në përfundim të procesit, u mbulua 31% e totalit të të certifikuarve, kryesisht për shkak të kontakteve të pasakta, ndërsa refuzimet përbënin një përqindje shumë të vogël.

Duke u bazuar në përvojën e katër viteve të fundit, edhe këtë vit u aplikua metoda e censusit për të certifikuarit e vitit 2024. Për kontaktimin e tyre u përdor baza e të dhënave e siguruar nga AKPA. Gjatë periudhës maj-qershor 2025 u anketuan 38.8% e të certifikuarve, ose 2,671 nga gjithsej 6,876 persona.

2.2 Instrumenti i studimit – pyetësoni

Të dhënat për studimin e gjurmimit, u bazuan në një pyetëson të standardizuar të organizuar me blloqe kryesore pyetjesh.

Duke pasur parasysh përvojën e viteve të kaluara, në pyetëson u bënë disa nishikime, si në lidhje me përmbajtjen, ashtu edhe me mënyrën e organizimit. Megjithatë, është patur parasysh që ndryshimet e bëra të ishin të tilla që të lejohej krahasimi me të dhënat e përfutuara më parë.

Duke u nisur nga fakti se qëllimi kryesor i pyetësorit ishte studimi i përfshirjes së kursantëve të certifikuar në tregun e punës, pyetja më kryesore ishte statusi i punësimit të të anketuarve në momentin e anketimit.

Grupet në të cilat ndaheshin të anketuarit ishin:

- të punësuar (të punësuar, studentë që punonin dhe studionin në të njëjtën kohë)
- të vetëpunësuar
- të papunë aktivë
- joaktivë (studentë, shtëpiakë, të dekurajuar, PAK)

Secili nga grupet kishte bllokun e pyetjeve korrespondente, sipas karakteristikave përkatëse.

Disa nga pyetjet për grupin e parë dhe të dytë (të certifikuarit në marrëdhënie pune), ishin:

- koha e gjetjes së punës ose e hapjes së biznesit
- mënyra e gjetjes së punës ose e hapjes së biznesit
- përputhja e kursit me vendin e punës
- intervali i pagës
- dobia e njohurive të marra në kurs në vendin e punës
- siguria dhe kënaqshmëria me vendin e punës

Për grupin e tretë ose të papunët:

- perceptimi mbi statusin
- roli i zyrave të punës për të gjetur punë

Për grupin e fundit ose të diplomuarit ekonomikisht joaktivë, rëndësi të veçantë kishin të dekurajuarit. Për ta, qëllimi ishte të merrej informacion pse ata nuk e mendonin veten të aftë për të gjetur një punë.

Për të gjithë të anketuarit, pavarësisht statusit të punësimit, u drejtua një grup i njëjtë pyetjesh mbi:

- nevojën për përmirësime në aspekte të veçanta në qendër
- perspektivën e tyre për të ardhmen profesionale.

Ashtu si dhe në anketimin e mëparshëm, u përdorën intervistat telefonike, me anë të një teknike të njohur si CATI (Computer-assisted telephone interviewing), në të cilën intervistuesi telefonon të anketuarin dhe regjistron përgjigjet e tij në një aplikacion kompjuterik, i cili administrohet online nëpërmjet përdorimit të Platformës Kobo Toolbox. Për administrimin e pyetësorit për kursantët e certifikuar, u angazhuan 7 persona, të cilët u trajnuan nga eksperti i metodologjisë për mënyrën e duhur të administrimit. Bazuar në të dhënat e mbledhura në raundin e mëparshëm të anketës së gjurmimit, u përllogarit se, koha mesatare që i duhej një anketuesi për të përfunduar një pyetësor, ishte 8-10 minuta.

2.3 Analizimi i të dhënave

Pas mbledhjes së të dhënave, u realizua pastrimi, tabulimi dhe analizimi i tyre duke përdorur programin statistikor SPSS. Tabulimi dhe analiza përfshijnë:

- përshkrimin deskriptiv të të dhënave nëpërmjet tabelave dhe grafikëve të ndryshëm.
- krahasimin me brezat e mëparshëm të gjurmuar.

Analiza është kryer për të gjitha pyetjet, të ndara sipas gjinisë, qendrës, si dhe statusit të punësimit.

2.4 Kufizimet metodologjike

Bazuar në faktin që anketa duhej të ishte census, të dhënat duhej të merrnin për të tërë popullatën, por vetëm 38.8% e të certifikuarve në vitin 2024 arritën të intervistoheshin. Kjo përqindje përgjigjesh, vjen kryesisht si pasojë e kontakteve të paplota dhe të gabuara të gjendura në databazën e popullatës. Me gjithë kufizimet në kontaktimin e të gjithë të certifikuarve, të dhënat e mbledhura janë të mjaftueshme për kryerjen e analizave të sakta dhe nxjerrjen e konkluzioneve përfaqësuese për popullatën, siç tregohet dhe në seksionin më poshtë, ku analizohet demografia.

3. PËRSHKRIMI I DEMOGRAFISË

Studimi kombëtar për gjurmimin e të certifikuarve nga qendrat e formimit profesional gjatë vitit 2024 përfshiu një kampion prej mbi 2,671 të certifikuar, me një normë pjesëmarrjeje prej 38.8% (llogaritur si raport i numrit të të anketuarve ndaj numrit total të të certifikuarve). Një tregues i rëndësishëm i përfaqësueshmërisë së të dhënave për secilën qendër formimi është niveli i përgjigjeve. Rezultatet e studimit tregojnë se shkalla e pjesëmarrjes për secilën qendër është brenda niveleve të pranueshme të përfaqësueshmërisë¹. Rrjedhimisht, çdo analizë e kryer mbi performancën e qendrave ka karakter përfaqësues për to.

Tabela 1. Pjesëmarrja sipas qendrave për vitin 2024

QFP	Të certifikuar	Të anketuar	Pjesëmarrja
QFP Durrës	638	274	42.9 %
QFP Elbasan	840	273	32.5 %
QFP Fier	449	190	42.3 %
QFP Gjirokastrë	696	221	31.8 %
QFP Korçë	353	128	36.3 %
QFP Nr.1 Tiranë	1,001	468	46.8 %
QFP Nr.4 Tiranë	964	409	42.4 %
QFP Shkodër	603	265	43.9 %
QFP Vlorë	627	257	41.0 %
QFP Lëvizëse	705	186	26.4 %
Total	6,876	2,671	38.8 %

Pyetësi i drejtuar të certifikuarve fillimisht mblodhi të dhëna demografike, duke përfshirë karakteristika e mëposhtme:

- Gjinia
- Moshë
- Qendra e formimit profesional ku është kryer kursi
- Statusi i punësimit para fillimit të kursit
- Përkatësia etnike
- Prania e aftësisë së kufizuar



1 Për çdo qendër vihet re një pjesëmarrje në studim e të paktën një në tre të certifikuar.

Këto të dhëna janë thelbësore jo vetëm për të identifikuar profilin demografik të pjesëmarrësve në studim, por edhe për të lejuar analiza të ndana sipas këtyre karakteristikave, duke siguruar një kuptim më të plotë të ndikimit të kursit të kryer në grupe të ndryshme.

3.1 Profili gjinor

Të dhënat e paraqitura në Tabelën 2 tregojnë se, gjatë vitit 2024, 52.4% e të certifikuarve ishin femra, ndërsa 47.6% meshkuj. Kjo shpërndarje gjinore reflekton një pjesëmarrje pak më të lartë të grave në popullatën e të certifikuarve². Në vazhdim, analiza e kampionit vërteton një shpërndarje të ngjashme, ku 51.9% e përgjigjeve janë nga femra dhe 48.1% nga meshkuj. Përputhja midis strukturës së popullatës së certifikuar dhe kampionit të anketuar tregon se procesi i kampionimit është kryer në mënyrë të balancuar, duke siguruar përfaqësueshmëri statistikore dhe besueshmëri të të dhënave.

Tabela 2. Shpërndarja sipas gjinisë

Gjinia	Të certifikuar	%	Të anketuar	%
Femra	3601	52.4	1385	51.9
Meshkuj	3275	47.6	1286	48.1
Total	6,876	100%	2,671	100%

3.2 Profili moshor

Tabela 3 paraqet një analizë krahasuese të strukturës moshore të popullsisë së certifikuar dhe kampionit të anketuar, të ndarë në pesë grupmosha kryesore. Rreth 60% e të certifikuarve dhe të anketuarve bëjnë pjesë në grupmoshat 16-34 vjeç, me një përqindje pak më të ulët (27.3%) të të anketuarve në grupmoshën 16-24 vjeç krahasuar me të certifikuarit (30.7%). Dallimi minimal në moshën mesatare (33.9 vjet për të anketuarit kundrejt 32.7 vjet për të certifikuarit) konfirmon që kampionimi është kryer në mënyrë të balancuar, duke ruajtur karakteristikat thelbësore të shpërndarjes moshore të popullsisë së certifikuar.

Tabela 3. Shpërndarja sipas grup moshës

	Të certifikuar (N=6,876)	Të anketuar (N=2,671)
16 - 24 vjeç	30.7%	27.3%
25 - 34 vjeç	29.1%	27.7%



2 Me termin popullatë do t'i referohemi të gjithë të certifikuarve, nga ana tjetër me termin të kampionuar do t'i referohemi vetëm të certifikuarve të cilët kanë marrë pjesë në studim.

	Të certifikuar (N=6,876)	Të anketuar (N=2,671)
35 - 44 vjeç	23.9%	25.8%
45 - 54 vjeç	11.7%	13.4%
55 + vjeç	4.6%	5.7%
Mosha mesatare	32.7	33.9

3.3 Profili sipas qendrave

Tabela 4 analizon shpërndarjen e të certifikuarve dhe të intervistuarve sipas qendrave. Të dhënat tregojnë QFP Nr.1 Tiranë ka numrin më të lartë si të certifikuar (1,001 ose 14.6%) ashtu edhe të anketuar (468 ose 17.5%). QFP Nr.4 Tiranë gjithashtu përfaqëson një pjesë të madhe me 14.0% të të certifikuarve dhe 15.3% të të anketuarve. Pra 28.6% e të certifikuarve kanë ndjekur trajnimet në qendrat e rajonit të Tiranës, një shifër që korrespondon me peshën demografike të këtij rajoni. Sipas INSTAT (2023), 31.6% e popullsisë banon në qarkun e Tiranës, duke justifikuar këtë përqindje.

Struktura e përfaqësimit është përgjithësisht e balancuar midis të certifikuarve dhe të anketuarve në shumicën e QFP-ve. Disa qendra si QFP Lëvizëse, Elbasan dhe Gjirokastër kanë një përfaqësim më të ulët në anketim krahasuar me numrin e të certifikuarve, por me diferenca të vogla.

Tabela 4. Shpërndarja e të certifikuarve dhe anketuarve sipas qendrave

QFP	Të certifikuar	%	Të anketuar	%
QFP Durrës	638	9.3	274	10.3
QFP Elbasan	840	12.2	273	10.2
QFP Fier	449	6.5	190	7.1
QFP Gjirokastër	696	10.1	221	8.3
QFP Korçë	353	5.1	128	4.8
QFP Nr.1 Tiranë	1,001	14.6	468	17.5
QFP Nr.4 Tiranë	964	14.0	409	15.3
QFP Shkodër	603	8.8	265	9.9
QFP Vlorë	627	9.1	257	9.6
QFP Lëvizëse	705	10.3	186	7.0
Total	6,876	100%	2,671	100%

3.4 Niveli ansimor

Më poshtë analizohet shpërndarja e të certifikuarve dhe të anketuarve sipas nivelit të ansimit. Rezultatet tregojnë një përputhje të lartë midis strukturës së të

certifikuarve dhe asaj të anketuarve, me dallime minimale në çdo kategori. Dallimet midis të certifikuarve dhe të anketuarve janë nën 1% për shumicën e kategorive, duke treguar një kampion të balancuar. Shumica e pjesëmarrësve kanë arsim të mesëm të lartë (afërsisht 61%), që tregon se formimet profesionale tërheqin kryesisht persona me diplomë të shkollës së mesme.

Tabela 5. Të certifikuarit dhe të anketuarit sipas nivelit arsimor

	Të certifikuar (N=6,876)	Të anketuar (N=2,671)
Arsim fillor (5 vjeçar)	0.1%	0.1%
Arsim i mesëm i ulët (9 vjeçar)	20.5%	21.0%
Arsim i mesëm i lartë (Gjimnaz i përgjithshëm / profesional)	61.3%	60.6%
Bachelor (3 vjeçar)	13.4%	13.2%
Master (shkencor/profesional)	4.5%	5.1%

3.5 Statusi i punësimit para kursit

Statusi i punësimit i popullatës së të certifikuarve para ndjekjes së kursit tregon se 30.9% e tyre ishin të punësuar para ndjekjes së kursit. Ndërkohë pjesa më e madhe rreth 64.7% ishin të papunë të regjistruar në zyrat e punës.

Tabela 6. Statusi i punësimit i popullatës së të certifikuarve para kursit

	Femra (N=3,601)	Meshkuj (N=3,275)	Total (N=6,676)
Punësuar /Vetëpunësuar	25.5%	36.8%	30.9%
Pa Punë regjistruar në ZP	69.5%	59.5%	64.7%
Pa Punë	3.4%	2.6%	3.0%
Tjetër	1.6%	1.1%	1.4%

Analiza e statusit të punësimit të të certifikuarve, bazuar në rezultatet e studimit të vitit 2024, tregon se pas përfundimit të kursit 63.5% e të anketuarve janë të punësuar. Krahasuar me nivelin e punësimit para ndjekjes së kursit (30.9%), ky tregues është pothuajse dyfishuar, duke dëshmuar qartë ndikimin pozitiv të programeve të trajnimit në rritjen e punësimit të personave të certifikuar.

3.6 Përkatësia etnike dhe aftësia e kufizuar

Saktësisht 99.0% e të anketuarve në qendrat e formimit profesional nuk i përkasin ndonjë grupit etnik, ndërsa 0.7% janë vetëdeklaruar si pjesë e komunitetit Rom dhe

0.3% si pjesë e komunitetit Egjiptian. Kjo shpërndarje etnike është konstatuar edhe në studimet e mëparshme, duke treguar një prirje të qëndrueshme në përfaqësimin e grupeve të ndryshme etnike në këto qendra.

Tabela 7. Shpërndarja e të anketuarve sipas përkatësisë etnike

	2021	2022	2023	2024
Nuk i përkas ndonjë pakice	98.7 %	98.5%	98.4%	99.0%
Rom	0.3%	1.1%	0.8%	0.7%
Egjiptian	1.0%	0.4%	0.7%	0.3%
Total	3,980	2,758	3,104	2,671

Sa i përket aftësisë së kufizuar, 98.6% e të anketuarve deklarojnë se nuk kanë ndonjë aftësi të kufizuar, ndërsa 1.4% raportojnë një lloj aftësie të kufizuar, pa e specifikuar natyrën e saj. Për të analizuar më në thellësi ndikimin që ndjekja e kurseve profesionale ka pasur tek kjo kategori, rekomandohet zbatimi i një metodologjie cilësore të mbledhjes së të dhënave përmes intervistave ballë për ballë dhe me një kampion të dedikuar, duke marrë parasysh nevojat dhe karakteristikat e veçanta të kësaj popullate.

4. SITUATA E PUNËSIMIT E TË CERTIFIKUARVE

Të dhënat e studimit për të certifikuarit në vitin 2024 e analizojnë statusin e punësimit të të certifikuarve në tri kategori kryesore: a) të punësuarit; b) të papunët; c) personat joaktivë në tregun e punës.

Sipas rezultateve të studimit të fundit, 63.5% e të certifikuarve janë të punësuar. Më specifikisht kategoria e të punësuarve përfshin nën kategoritë si më poshtë dhe më përqindjet përkatëse referuar studimit të fundit:

- a. të punësuarit me 48.2%,
- b. të vetëpunësuar me 15.1%
- c. personat që punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë, me 0.2%.

Grupi i dytë më i madh është ai i të papunëve, që përfaqëson 12.1% të të certifikuarve. Kjo kategori përfshin individët që e kanë përfunduar kursin dhe janë në kërkim aktiv të punës.

Kategoria e tretë është ajo e personave joaktivë në tregun e punës, të cilët përfaqësojnë 24.4% të të certifikuarve të anketuar. Në mënyrë më specifike kjo kategori përfshin:

- a. të papunët e dekurajuar, pra ata që janë të papunë por që nuk kërkojnë një punë (12.0%)
- b. ata që janë në ndjekje të një kualifikimi të mëtejshëm (6.0%)
- c. ata që janë duke përmbushur detyrat shtëpiake (2.4%)
- d. pjesa tjetër të deklaruar, si të paaftë përkohësisht ose tjetër (pensionistë etj.) 4.0%.

Analiza e treguesve të punësimit për të certifikuarit gjatë periudhës 2019-2024 evidenton zhvillime pozitive në integrimin e tyre në tregun e punës, pavarësisht disa luhatjeve ndër vite.


Përqindja e të certifikuarve të punësuar është rritur ndjeshëm, nga 39.0% në vitin 2019 në 48.2% në vitin 2024, megjithëse ka një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2023, kur kjo përqindje ishte 51.7%. Ndërkohë, pjesa e të vetë-punësuarve ka pasur një rritje të qëndrueshme. Të dhënat tregojnë gjithashtu një ulje të konsiderueshme të përqindjes së të papunëve në kërkim aktiv pune, nga 31.8% në vitin 2019 në 12.1% në vitin 2024. Grupi i personave joaktivë në tregun e punës (ata që nuk janë në kërkim të një pune) shënon 24.4%, me një rritje të lehtë në krahasim me një vit më parë, 23.6%.

Tabela 8. Statusi i punësimit sipas kategorive dhe viteve të certifikimit

		2019	2021	2022	2023	2024
Të punësuar	I/E punësuar	39.0%	43.7%	44.3%	51.7%	48.2%
	I/E vetë-punësuar	8.8%	14.4%	16.1%	14.6%	15.1%
	Punoj dhe studioj (ose trajnohem) në të njëjtën kohë	0.6%	0.7%	0.5%	0.7%	0.2%
	Të punësuar total	48.4%	58.8%	60.9%	67.0%	63.5%
Të papunë	Pa punë dhe po kërkoj për punë	31.8%	20.3%	15.4%	9.4%	12.1%
Inaktiv	Pa punë por nuk kërkoj për punë	8.8%	13.1%	10.7%	9.2%	12.0%
	Student/Kursant në trajnim të mëtejshëm	4.1%	5.4%	7.1%	6.1%	6.0%
	Në paaftësi të përhershme	0.5%	0.3%	0.8%	0.7%	0.7%
	Duke përmbushur detyrat shtëpiake (shtëpiak/e)	3.2%	0.5%	3.6%	4.2%	2.4%
	Tjetër	3.1%	1.5%	1.4%	3.4%	3.3%
	Inaktiv total	19.7%	20.8%	23.6%	23.6%	24.4%

Në mënyrë më të përmbledhur mund të themi se përqindja e kategorisë së të certifikuarve të punësuar është rritur vazhdimisht nga 48.4% (2019) në 63.5% (2024), me një rritje totale prej 15.1 pikë përqindje në këto vite. Në krahasim me vitin 2024, ka një rënie të lehtë, por sidoqoftë niveli i punësimit mbetet dukshëm më e lartë se nivelet e viteve 2019-2022. Gjithashtu dhe nivelet e të papunëve të të certifikuarve kanë pësuar një rritje të lehtë në krahasim me një vit më parë, në 12.1% në krahasim me 9.4% në vitin 2023, por sërish mund të themi se kemi me shumë se një përgjysmim të këtij treguesi në krahasim me vitin 2019. Nga ana tjetër grupi jo aktiv paraqitet në të njëjtat nivele (rreth 20-24%), me një rritje të vogël në 24.4% (2024).

Graf. 1 Statusi aktual i punësimit (2019-2024)



5. TË CERTIFIKUARIT E PUNËSUAR

Sig u analizua dhe më lart të dhënat e vitit 2024 tregojnë për një rënie të lehtë të punësimit krahasuar me një vit më parë (nga 66.9% në 2023 në 63.5% në 2024). Megjithatë, ky tregues i analizuar sipas qendrave luhatet ndjeshëm nga një qendër në tjetrën. Më poshtë paraqitet statusi i punësimit sipas qendrave për studimet e tre viteve të fundit.

Qendrat me punësim më të lartë të të certifikuarve për vitin 2024, janë ajo e Durrësit me 73%; e Vlorës me 70.4%; dhe QFP Gjirokastër: 69.7%. Nga ana tjetër qendrat me punësim më të ulët janë Qendra e Lëvizshme me 41.9% të të certifikuarve të punësuar; QFP Fier me 55.3% dhe QFP Korçë me 58.6% të certifikuarve të punësuar.


Qendrat që shfaqin një rritje të punësimit në krahasim me një vit më parë janë ajo e Vlorës, Shkodrës dhe Gjirokastrës. Mund të theksojmë se QFP Shkodër shfaq përmirësimin më të lartë të punësimit gjatë periudhës 2022-2024.

Tabela 9. Të punësuarit sipas qendrave dhe viteve të certifikimit

	2022	2023	2024
QFP Durrës	60.0%	74.4%	73.0%
QFP Elbasan	58.5%	65.0%	62.6%
QFP Fier	62.8%	65.4%	55.3%
QFP Gjirokastër	63.8%	57.2%	69.7%
QFP Korçë	64.3%	62.0%	58.6%
QFP Nr.1 Tiranë	66.0%	68.4%	58.8%
QFP Nr.4 Tiranë	63.9%	80.0%	69.7%
QFP Shkodër	39.3%	55.1%	65.3%
QFP Vlorë	66.4%	67.7%	70.4%
Qendra e Lëvizshme	55.6%	52.5%	41.9%
Total	60.90%	66.90%	63.5%

Të dhënat për të punësuarit e certifikuar sipas gjinisë tregojnë një rritje të vazhdueshme të punësimit për të dyja gjinitë gjatë periudhës 2019-2024. Në vitin 2024, 72.9% e meshkujve të certifikuar rezultojnë të punësuar, krahasuar me 54.9% të femrave, duke reflektuar një diferencë gjinore prej 18 pikë përqindjeje. Kjo diferencë ka qenë e pranishme gjatë gjithë periudhës, megjithëse me luhatje. Gjithashtu studimi i vitit 2024 tregon një rënie të lehtë për të dy gjinitë në krahasim me një vit më parë, përkatësisht me 2.5 pikë përqindjeje për femrat dhe 2.9 pikë përqindjeje për meshkujt.

Graf. 2 Të certifikuarit e punësuar sipas gjinisë (2019-2024)



Analiza sipas statusit të punësimit para ndjekjes së kursit tregon se 88.7% e atyne që ishin të punësuar vijojnë të jenë në punë, ndërsa nga grupi i të papunëve, 49.0% kanë arritur të punësohen. Këto të dhëna konfirmojnë ndikimin pozitiv të programeve të formimit profesional në përmirësimin e nivelit të punësimit të të certifikuarve.

Tabela 10. Të punësuar sipas statusit të punësimit para kursit

Statusi i punësimit para kursit	Niveli punësimit pas kursit
I Punësuar	88.7%
Pa punë	49.0%
Tjetër	57.9%
Total	63.5%

Analiza e situatës së punësimit sipas përkatësisë etnike tregon se niveli i punësimit tek të certifikuarit nga grupet Rom/Egjiptian është ndjeshëm më i ulët (26.9%) krahasuar me totalin e përgjithshëm (63.5%). Përqindja e të papunëve në këtë grup është 34.6%, ndërsa në totalin e të certifikuarve kjo shifër është 12.1%. Gjithashtu, niveli i inaktivitetit rezulton më i lartë për grupin Rom/Egjiptian (38.5%) në krahasim me totalin (24.4%).

Tabela 11. Situata e punësimit sipas përkatësisë etnike³

	Rom/Egjiptian	Total
Të punësuar	26.9%	63.5%
Të papunë	34.6%	12.1%
Inaktivë	38.5%	24.4%



3 Vlen të theksohet se për shkak të numrave të vegjël që ata kanë në anketim komuniteti Rom dhe Egjiptian, rezultatet duhen marrë me rezerva. Sidoqoftë numrat tregojnë për një diferencë të theksuar në krahasim me popullsinë e cila nuk i përket ndonjë pakice etnike.

5.1 Karakteristikat kryesore në punën aktuale

Një aspekt i rëndësishëm i analizës së të certifikuarve të punësuar (duke përjashtuar të vetë-punësuarit për këtë seksion) është integrimi i tyre në vendin e punës.

Tabela 12 analizon shpërndarjen e përqindjes së të certifikuarve sipas kohëzgjatjes në punësimin aktual, nga viti 2019 deri në 2024. Të dhënat për këtë periudhë kohore zbulojnë dy trende kryesore: Së pari vihet re një **rritje e qëndrueshmërisë afatgjatë në punësimin e të certifikuarve**. Pjesa e të certifikuarve të punësuar me më shumë se 12 muaj është rritur nga 42.4% (2019) në 62.7% (2024). Kjo rritje prej 20 pikësh përqindje tregon përminësim të dukshëm në stabilizimin e punësimit. Ky trend ka shënuar një rritje konsistente çdo vit (50.8% në 2021, 57.4% në 2022). Të dhënat sipas gjinisë tregojnë se 66.6% e të punësuarve meshkuj punojnë me një kohëzgjatje më shumë se 12 muaj kundrejt 58.5% të femrave.

Së dyti, kemi një reduktim të qarkullimit të shpejtë në punësimin e të certifikuarve. Vihet re një rënie të përqindjes së të certifikuarve të punësuar për kategoritë afatshkurta. Konkretisht niveli i të punësuarve më pak 6 muaj është përgjysmuar (14.4% në vitin 2024 vs 29.9% në vitin 2019).

Tabela 12. Kohëzgjatja në punën aktuale sipas viteve të certifikimit (2019-2024)

	2019	2021	2022	2023	2024
Më pak se 1 muaj	2.5%	4.8%	5.4%	2.2%	2.2%
1 -3 muaj	7.5%	11.9%	6.9%	4.6%	5.3%
3 - 6 muaj	10%	13.1%	10.4%	6.2%	6.9%
6 - 9 muaj	11.2%	9.5%	10.2%	10.8%	13.1%
9-12 muaj	6.3%	10.0%	9.6%	13.3%	9.9%
Mbi 12 muaj	42.4%	50.8%	57.4%	62.9%	62.7%
Tjetër	20%	-	-	-	-

Më poshtë paraqitet një analizë e mënyrës se si personat e certifikuar nga qendrat e formimit profesional kanë gjetur punën e tyre aktuale. Gjatë pesë viteve të fundit, vërehet një ndryshim thelbësor në këtë aspekt: **nga një varësi e lartë ndaj lidhjeve personale drejt një orientimi më të madh drejt aplikimeve të drejtpërdrejta dhe platformave të rekrutimit online.**

Veçanërisht bie në sy një rënie e ndjeshme e rolit të njohjeve personale në procesin e punësimit. Të dhënat krahasuese tregojnë se në vitin 2019, 55.4% e të punësuarve të certifikuar e kishin siguruar punën përmes rrjetit personal apo familjar, ndërsa në vitin 2024 kjo përqindje ka rënë në 33.8%. **Ky ndryshim nënvizon një transformim në drejtim të një tregu pune më të hapur dhe meritokratik, ku aftësitë profesionale kanë filluar të zëvendësojnë lidhjet personale.**

Në të njëjtën kohë, vërehet **një rritje e ndjeshme e përdorimit të aplikimeve të drejtpërdrejta** (nëpërmjet dërgimit të CV-së apo kontaktit direkt me punëdhënësin). Në vitin 2019, kjo mënyrë përfaqësonte 20.4% të rasteve të punësimit, ndërsa në vitin 2024 ka arritur në 31.6%, duke reflektuar një rritje prej 11.2 pikësh përqindje. Kjo tregon se të certifikuarit janë gjithnjë e më të ndërgjegjshëm dhe proaktivë në kërkimin e punës, si dhe më të sigurt në aftësitë e tyre për të aplikuar në mënyrë të pavarur.

Një tjetër trend në rritje është përdorimi i internetit dhe rrjeteve sociale si kanale për të gjetur punë. Në vitin 2019, vetëm 9.4% e të certifikuarve raportuan se kishin gjetur punë përmes lajmërimeve online, ndërsa në vitin 2024 kjo shifër është rritur në 22.5%. Ky më shumë se dyfishim dëshmon rritjen e ndikimit të platformave digjitale në proceset e rekrutimit.


Nga ana tjetër praktika profesionale ka një ndikim të vogël (1-2.6%); roli i instruktonëve/stafit të qendrës është minimal (0.3-1.5%), agjencitë private kanë ndikim shumë të ulët (<0.5%). Gjithashtu, zyrat shtetërore të punësimit dhe portali kombëtar i punësimit nuk përfaqësojnë ende burime të rëndësishme për gjetjen e punës, duke treguar për nevojën për rritjen e efektivitetit të këtyre mekanizmave dhe forcimin e rolit të tyre në mbështetjen e punëkërkuësve.

Tabela 13. Mënyra e gjetjes së punës sipas viteve të certifikimit (2019-2024)

	2019	2021	2022	2023	2024
Nëpërmjet Zyrës së Punës	6.3%	2.7%	7.9%	3.0%	3.6%
Nëpërmjet përgjigjes së lajmërimeve të publikuara në faqe interneti, media sociale etj.	9.4%	17.2%	10.7%	9.0%	22.5%
Nga praktika profesionale në biznes	1.0%	0.9%	2.6%	2.5%	1.7%
Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve	55.4%	56.0%	55.7%	50.3%	33.8%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim (duke dërguar CV etj.	20.4%	17.5%	19.4%	29.3%	31.6%
Nga instruktorët/ stafi i qendrës	0.7%	1.5%	0.8%	0.5%	0.3%
Nëpërmjet një agjencie private të punësimit	0.2%	0.1%	0.2%	0.5%	0.3%
Nëpërmjet portalit kombëtar të punësimit puna.gov.al				4.2%	0.8%
Tjetër		4.1%	2.6%	0.8%	5.4%


Më poshtë analiza përqendrohet tek ata të certifikuar të cilët kanë qenë në punë dhe para ndjekjes së kursit. Të dhënat tregojnë se 81.1% e tyre vazhduan të punojnë në të njëjtën punë. Këto rezultate zbulojnë një trend pozitiv, me një rritje të dukshme të qëndrueshmërisë në punë për të certifikuarit në vitin 2024 dhe janë në një linjë me gjetjet e mësipërme sa i takon kohëzgjatjes së të punësuarve në punën aktuale.

Graf. 3 Punësimi në të njëjtin vend sipas viteve të certifikimi (2019-2024)



Sipas të dhënave të studimit të vitit të fundit, mbi 94% e punonjësve janë të punësuar me kohë të plotë në vendet e tyre aktuale të punës. Kjo tendencë korrelohet drejtpërdrejt me gjetjet e mëparshme, të cilat tregojnë një rritje të qëndrueshmërisë së punësimit, ku punonjësit jo vetëm që mbajnë pozicionin e tyre për një kohë më të gjatë, por edhe punohen me kohë të plotë. Këto dy tregues paralelë, rritja e punësimit me kohë të plotë dhe reduktimi i qarkullimit të stafit, konfirmojnë një forcim të qëndrueshëm të tregut të punës.

Graf. 4 Lloji i punësimit sipas viteve të studimit (2019-2024)



Të certifikuarit e punësuar kryesisht janë të punësuar në ndërmarrje mikro (1-9 punonjës) dhe të vogla (10-49 punonjës), duke përbërë 80% të totalit. Pjesa e mbetur prej 20% punon në ndërmarrje të mesme (50-249 punonjës) ose të mëdha (250+ punonjës). Kjo shpërndarje paraqitet e qëndrueshme ndër vite pasi korrespondon me strukturën e bizneseve në vend, ku sipas të dhënave të Regjistrimit të Bizneseve (INSTAT, 2024), 99% e bizneseve aktive në vend janë me më pak se 50 punonjës. Kjo pasqyron një ekonomi ku bizneset e vogla dhe mikro-janë shtylla kryesore e punësimit, duke përfshirë edhe punësimin e të certifikuarve.

Tabela 14. Madhësia e subjektit ku janë të punësuar të certifikuar (2020-2024)

	2021	2022	2023	2024
Ndërmarrje Mikro (1-9 të punësuar)	45.7%	48.3%	38.7%	44.5%
Ndërmarrje e Vogël (10-49 të punësuar)	29.7%	34.1%	40.7%	35.5%
Ndërmarrje e Mesme (50-249 të punësuar)	14.9%	12.6%	16.1%	15.6%
Ndërmarrje e Madhe (250+ të punësuar)	9.6%	5.0%	4.5%	4.4%

Vërehet një trend pozitiv në perceptimet e të certifikuarve të punësuarve për sigurinë në punën aktuale- me një rritje të të punësuarve që ndihen "të sigurt" ose "shumë të sigurt" nga 55.6% (2020) në 59.8% (2024), dhe një rënie të konsiderueshme të atyne që ndihen "të pasigurt" nga 17.4% në 5.5% për të njëjtën periudhë.

Tabela 15. Qëndrueshmëria në punën aktuale (2020-2024)

	2020	2022	2023	2024
Shumë i/e pasigurt	7.1%	2.0%	1.7%	1.2%
I/e pasigurt	10.3%	4.0%	1.9%	4.3%
As i sigurt as i pasigurt/ neutral	27.0%	14.7%	32.8%	34.7%
I/e sigurt	39.8%	54.6%	45.6%	46.5%
Shumë i/e sigurt	15.8%	24.8%	18.0%	13.3%

5.2 Integrimi në tregun e punës – të ardhurat

Analiza e të dhënave tregon një përmirësim të dukshëm në strukturën e të ardhurave nga puna gjatë periudhës 2019-2024. Trendi më i dukshëm është reduktimi dramatik i përqindjes së kategorisë të të certifikuarve të punësuar me të ardhurave më të ulëta (deri në 40.000 lek), e cila është përgjysmuar nga 47.2% në 2019 në vetëm 5.8% në 2024. Paralelisht, vërehet një rritje e qëndrueshme e të ardhurave në kategorinë 50-95 mijë lek në krahasim me vitin 2019: më specifikisht kategoria 50.001-60.000 lek (nga 11.6% në 31.5%) dhe kategoria 60.000-95.000 lek (nga 2.7% në 29.3%). Kjo zhvendosje tregon një përmirësim të përgjithshëm në shpërndarjen e të ardhurave nga paga.

Tabela 16. Të ardhurat nga puna (2019-2024)

	2019	2021	2022	2023	2024
Deri në 40.000 Lek	47.2%	49.7%	17.1%	6.1%	5.8%
40.001-50.000 Lek	19.4%	17.3%	22.7%	19.9%	15.2%
50.001-60.000 Lek	11.6%	10.3%	19.5%	31.4%	31.5%
60.000-95.000 Lek	2.7%	5.2%	11.6%	25.1%	29.3%

	2019	2021	2022	2023	2024
95.001-120.000 Lek	0.3%	1.6%	1.5%	6.0%	4.2%
Mbi 120.000 Lek	0.5%	1.2%	0.3%	4.6%	1.0%
Refuzim	18.30%	14.7%	27.3%	7.0%	13.1%

Analiza e të dhënave për perceptimin e të ardhurave tregon një trend pozitiv dhe të qëndrueshëm nga të certifikuarit e punësuar gjatë periudhës 2019-2024. Rritja e përqindjes së atyre që deklarojnë rritje të të ardhurave është e dukshme dhe e vazhdueshme: nga 28% në 2019 në 55.5% në 2024. Ky trend pozitiv shoqërohet me një ulje të përqindjes së të punësuarve të cilët mendojnë se të ardhurat janë pandryshuara (nga 66.2% në 2021 në 43.9% në 2024),


Tabela 17. Perceptimi për të ardhurat (2019-2024)

	2019	2021	2022	2023	2024
Janë rritur	28.0%	32.5%	48.5%	49.9%	55.5%
Janë ulur	42.1%	1.2%	0.2%	0.9%	0.6%
Nuk kanë ndryshuar	29.9%	66.2%	51.4%	49.2%	43.9%

5.3 Përputhshmëria e trajnimit


Sipas të dhënave të studimit më të fundit, 50.2 % e të punësuarve vlerësojnë se trajnimet e kryera kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me detyrat e tyre aktuale profesionale. Edhe pse ky tregues paraqet një ulje në krahasim me një vit më parë, tendenca e përgjithshme mbetet në rritje, duke treguar një përminësim progresiv në përputhshmërinë e programeve të trajnimit profesional me kërkesat e tregut të punës. Analiza gjinore tregon se përqindja e femrave që deklarojnë përputhshmëri midis kursit të ndjekur dhe punës aktuale është disi më e ulët (48.4%) krahasuar me meshkujt (51.8%).

Graf. 5 Lidhja e kursit me punën aktuale (2019-2024)



Të dhënat në Graf. 6 tregojnë përqindjen e të certifikuarve në secilin QFPP (Qendër Formimi Profesional Publik) që deklarojnë se kursi i ndjekur ka lidhje me punën e tyre aktuale. Të dhënat për këtë përputhshmëri tregojnë se ka një variacion midis qendrave. Personat që kanë ndjekur kurset në qendrën e Durrësit dhe Elbasanit deklarojnë një përputhshmëri të lartë, përkatësisht 60.8% dhe 56.2%. Nga ana tjetër të certifikuarit e trajnuar në Qendrën Korçë dhe Vlorë paraqesin vlera më të ulta të këtij treguesi, 43.6% dhe 42.4%.

Graf. 6 Lidhja e kursit me punën aktuale sipas qendrave



Nga të dhënat e paraqitura, shihet një trend i qartë në ansyet e përzgjedhjes së një pune të ndryshme nga ajo e trajnimit nga viti 2020 deri në 2024. Rritja e peshës së pagës dhe kushteve më të mira tregon se **motivimi financiar është bërë shumë më i rëndësishëm** me kalimin e kohës në përzgjedhjen e një pune. Në 2020, vetëm 33.7% e të certifikuarve deklaruan se zgjedhën një punë që nuk ka lidhje me trajnimin për shkak të pagës/kushteve më të mira. Kjo përqindje u rrit ndjeshëm në 2022 (43.6%), 2023 (55.2%) dhe mbetet e lartë në 2024 (53.7%).

Përveç kësaj, **ka një rënie të dukshme të mungesës së vendeve të punës që lidhen me fushën e trajnimit në krahasim me vitin 2020**. Në këtë vit, 35.6% e të anketuarve deklaruan se nuk gjetën punë në profesionin e tyre, por kjo përqindje është ulur gradualisht në 29.9% (2022), 19.7% (2023) dhe 23.5% (2024). Edhe pse me një rritje të lehtë vitin e fundit trendi i përgjithshëm paraqitet në rënie duke sugjeruar një përmirësim të përputhshmërisë midis trajnimit dhe ofertave të punësimit.

Gjithashtu vihet re se të certifikuarit janë më të kënaqur me profesionet dhe trajnimin e zgjedhur pasi kemi **një pakësim të mungesës së dëshirës për të punuar në fushën e trajnimit**. Në 2020, 15% e të anketuarve thanë se nuk donin të punonin në fushën e tyre të trajnimit. Kjo përqindje u ul në 9.5% (2022 dhe 2023) dhe 7.7% (2024).


Tabela 18. Arsyet e përzgjedhjes së një pune ndryshe nga ajo e trajnimit (2020-2024)

	2020	2022	2023	2024
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	33.7%	43.6%	55.2%	53.7%
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me trajnimin tim	35.6%	29.9%	19.7%	23.5%
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me trajnimin tim	15.0%	9.5%	9.5%	7.7%
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajonin ku punoj	6.0%	5.3%	4.2%	3.9%
Tjetër	9.8%	11.7%	11.4%	11.3%

Në vitin 2024, përdorimi i njohurive të fituara nga trajnimi në punën aktuale ka regjistruar një rënie prej 69.9% në vitin 2023 në 60.6%, megjithatë ky tregues mbetet dukshëm më i lartë në krahasim me të gjitha vitet e mëparshme para 2023, gjë që dëshmon se shumica e të certifikuarve vazhdojnë të aplikojnë në masë të konsiderueshme njohuritë e marra nga trajnimet. Nga ana tjetër, 31.9% e punësuarve raporton një mospërputhje midis trajnimit të kryer dhe detyrave të punës aktuale.

Analiza sipas gjinisë e të punësuarve të certifikuar tregon se meshkujt i përdorin më shumë njohuritë e marra në trajnim në krahasim me të certifikuarat femra ku përqindja që deklaroi se i përdor shumë ose jashtëzakonisht shumë është për meshkujt 63.9% dhe për femrat 56.5%.

Graf. 7 Përdorimi i njohurive në punë aktuale (2019-2024)




5.4 Të certifikuarit e vetëpunësuar

Një pjesë e rëndësishme e grupit të të certifikuarve të punësuar përfaqësohet nga të vetëpunësuarit, të cilët zënë një peshë të konsiderueshme brenda kësaj kategorie. Duke qenë se ky grup ka pasur një pjesë të dedikuar në pyetësor dhe paraqet karakteristika specifike, ky seksion i kushton vëmendje në mënyrë të fokusuar vetëm kësaj nënkategorie.

Rezultatet kryesore theksojnë ndryshime në shpërndarjen e të vetëpunësuarve në varësi të rajonit. Konkretisht QFP Gjirokastrë (20.4%), QFP Shkodër (18.9%) dhe QFP Fier (18.8%) regjistrojnë përqindjet më të larta të të certifikuarve që janë të vetëpunësuar. Vlera mbi nivelin e përgjithshëm (15.1%, e treguar me vijë horizontale në grafikun përkatës) e tejkalojnë edhe QFP Elbasan (17.6%) dhe QFP Durrës (16.1%). Në anën tjetër, Qendra e Lëvizshme (11.1%) dhe QFP Nr.1 Tiranë (10.7%) kanë përqindjet më të ulëta të të vetëpunësuarve në krahasim me qendrat e tjera.


Graf. 8 Shpërndarja e të vetëpunësuarve sipas qendrave 2024



Rezultatet për të gjithë të punësuarit zbuluan se gjysma e të punësuarve po punojnë në një punë që ka lidhje me kursin e zhvilluar. Megjithatë po të fokusohemi vetëm tek të punësuarit kjo situatë duket se është shumë më pozitive. Të dhënat tregojnë se rreth 85.1% e të vetëpunësuarve po punojnë në një biznes i cili ka lidhje me trajnimin e zhvilluar. Këto rezultate janë në rritje në krahasim me një vit më parë me një rritje 2.4 pikë përqindje, por dhe trendi i përgjithshëm gjatë periudhës 2019-2024 është në rritje duke treguar një përmirësim të qëndrueshëm në kohë.

Injërti tregues i analizuar sipas gjinisë tregon se nuk ka diferenca për të vetëpunësuarit femra dhe meshkuj kur për të dy gjinitë ky tregues është 85.3% dhe 85% përkatësisht.

Graf. 9 Lidhja e fushës së biznesit me trajnimin (2019-2024)



Një nga treguesit kryesorë për matjen e efektivitetit të kurseve profesionale është koha e nevojshme që të vetëpunësuarit të hapin biznesin e tyre pas përfundimit të trajnimit. Të dhënat e vitit 2024 ofrojnë një pasqyrë të qartë të ndikimit të këtyre programeve në nismën e biznesit. Më konkretisht një përqindje e konsiderueshme prej 25.4% e pjesëmarrësve hapi biznesin brenda 1 muaj pas përfundimit të kursit, duke treguar një efektivitet të lartë të trajnimeve në nxitjen e veprimit të shpejtë. Kjo përqindje përfaqëson nivelin më të lartë të regjistruar në vitet e fundit, duke theksuar përminësimin e impaktit të trajnimit në hapjen e biznesit në vitin 2024. Vazhdon mbizotërimi i bizneseve ekzistuese, ku 40.6% e bizneseve ishin të hapura para ndjekjes së kursit, ndërsa 19.2% kanë karakter familjar. Kjo strukturë tregon se një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve kanë jetëgjatësi në biznes, por trajnimi ka kontribuar në përminësimin e aftësive të tyre. Përqindja e bizneseve të hapura pas 3 muajsh ose më shumë është ulur, me vetëm 7.7% në 1-3 muaj, 3.0% në 3-6 muaj, dhe 4.0% në periudhën 6-12 muaj.


Tabela 19. Koha për hapjen e biznesit (2019-2024)

	2019	2021	2022	2023	2024
Është biznesi i familjes	28.5%	13.7%	17.2%	25.8%	19.2%
E kam hapur para kursit	44.4%	58.8%	58.2%	39.8%	40.6%
1 muaj pas kursit	5.6%	7.8%	11.1%	8.4%	25.4%
1 -3 muaj pas kursit	7.2%	8.6%	6.8%	10.4%	7.7%
3 - 6 muaj pas kursit	6.1%	5.3%	2.9%	8.2%	3.0%
6 - 9 muaj pas kursit	2.1%	2.0%	2.0%	1.8%	1.5%
9 - 12 muaj pas kursit	6.1%	3.8%	1.8%	5.6%	2.5%

Duke u përqendruar tek numri i punonjësve në bizneset që drejtohen nga të vetëpunësuarit (duke mos i përfshirë ata) vihet re një rritje e bizneseve pa punonjës (68.8% në 2024) në krahasim me 43.1% në 2013. Rezultatet korrelojnë me gjetjet e mësipërme ku u vu re një rritje e bizneseve hapur vetëm 1 muaj pas kursit. Në

këto kushte të vetëpunësuarit janë në fillim të aktivitetit si biznese individuale me perspektivën për t'u rritur në të ardhmen.

Graf. 10 Numri i të punësuarve në biznesin privat/familjar (2019-2024)



Sipas të dhënave për të certifikuarit në vitin 2024, 82.2% e të vetëpunësuarve e shohin vetëpunësimin si një aktivitet të përhershëm, duke reflektuar një prirje të qëndrueshme rritëse që nga viti 2019. Ky trend tregon qartë se vetëpunësimi po shndërrohet gradualisht në një model të qëndrueshëm karriere dhe jo thjesht si zgjidhje emergjente.

Të dhënat sipas gjinisë për vetëpunësimin si karrierë e përhershme tregojnë se meshkujt janë më të prirur ta shohin vetëpunësimin si zgjidhje të përhershme. Rreth 85.2% e meshkujve e shohin vetëpunësimin si aktivitet të përhershëm, ndërkohë 76.1% e femrave e konsiderojnë atë si karrierë afatgjatë.


Tabela 20. Perspektiva e vetëpunësimit (2019-2024)

	2019	2021	2022	2023	2024
E shoh si një aktivitet të përhershëm timin	74.5%	67.5%	77.3%	79.5%	82.2%
E shoh si një aktivitet të përkohshëm deri në një punësim më të sigurt në një kompani	15.3%	21.8%	14.5%	11.1%	10.6%
Nuk e di	9.1%	9.5%	7.7%	8.4%	5.3%
Tjetër	1.1%	1.2%	0.5%	1.1%	2.0%

6. TË CERTIFIKUARIT E PAPUNË


Në këtë seksion do të analizohet situata e të certifikuarve të cilët janë të papunë. Kujtojmë këtu se të papunë janë ata persona të cilët edhe pse nuk kanë një punë janë në kërkim aktiv për të gjetur një të tillë. Të dhënat tregojnë një trend të qartë zbritës në përqindjen e të certifikuarve të papunë pas përfundimit të trajnimeve profesionale gjatë periudhës 2019-2024, me një rritje të lehtë në vitin 2024 në krahasim me një vit më parë. Të dhënat sipas gjinisë tregojnë se ndër të certifikuara femra 14.7% janë të papuna kundrejt 9.3% meshkuj.

Graf. 11 Të certifikuarit e papunë (2019-2024)



Të dhënat e vitit 2024 tregojnë shpërndarje të pabarabartë të nivelit të papunësisë mes të certifikuarve nga qendrat e trajnimit profesional. Qendra e Lëvizshme (25.3%), Tiranë Nr.1 (15.8%) dhe QFP Fier (30.7%) kanë përqindjet më të larta të të certifikuarve të papunë. Qendrat me performancë më të mirë paraqiten ajo e Durrësit (5.1%) dhe QFP Gjirokastrë (7.7%), QFP Korçë (7.8%) me përqindje më të ulëta të certifikuarve të papunë.


Graf. 12 Të certifikuarit e papunë sipas qendrave



6.1 Punësimi i mëparshëm

Studimi i vitit të fundit, në përputhje me studimet e mëparshme, tregon se shumica e të papunëve nuk kanë pasur eksperiencë të mëparshme pune. Konkretisht, 74.1% e tyre nuk kanë punuar më parë, ndërsa vetëm 25.9% kanë pasur një përvojë pune të mëparshme. E analizuar sipas gjinisë, vihet re se meshkujt e papunë kanë një përqindje më të lartë të përvojës së mëparshme në punë krahasuar me femrat. Përkatësisht, 33.6% e të papunëve meshkuj kanë pasur një punë më parë, kundrejt 21.3% të femrave.

Graf. 13 Punësimi i mëparshëm për të papunët (2019-2024)



Pëngjatë gjithë periudhës, arsyet personale janë nenditur si arsyeja kryesore për largimin nga puna, ku dhe në vitin 2024, kjo përqindje mbetet e lartë (51.4%). Përfundimi i kontratës është arsyeja e dytë në largimin nga puna e mëparshme për të papunët, 15%, tregues ky i cili është në rritje në krahasim me një vit më parë.


Tabela 21. Arsyet e largimit nga puna (2019-2024)

	2019	2021	2022	2023	2024
Për arsye personale	35.9%	37.6%	53.4%	54.8%	51.4%
Më mbaroi kontrata e punës	13.7%	11.8%	11.2%	9.4%	15.0%
Kishte shkurtime në vendin e punës	12.0%	15.1%	5.3%	6.0%	5.1%
Mu ofrua një pagë më e mirë te puna e re	4.3%	0.6%	5.3%	1.0%	1.9%
Vendi i punës nuk përputhej me trajnimin tim	2.6%	3.3%	4.4%	2.0%	1.4%
Kërkesat e punës ishin më të larta se aftësitë e zotëruara	1.3%	0.6%	0.5%	0.3%	1.4%
Tjetër	30.3%	31.1%	19.9%	26.4%	23.8%

6.2 Të kërkuarit për punë

Të dhënat për vitin 2024 tregojnë nivelin më të lartë të angazhimit në kërkimin aktiv për punë nga ana e të certifikuarve të papunë. Në total, 81.0% e tyre raportojnë se kanë ndërmarrë veprime konkrete për të gjetur punë gjatë katër javëve të fundit, ndërsa vetëm 19.0% nuk kanë qenë aktivë në këtë drejtim. Ky rezultat reflekton një rritje të qëndrueshme të motivimit dhe gatishmërisë për t'u integruar në tregun e punës.

Graf. 14 Kërkimi i një pune 4 javët e fundit (2019-2020)



Të dhënat për vitin 2024 tregojnë zhvillime të rëndësishme në mënyrat e kërkimit të punës nga të certifikuarit e papunë, duke reflektuar një ndryshim të qartë në kanalet e përdorura krahasuar me vitet e mëparshme.

Përdorimi i Zyrës së Punës ka shënuar një rritje të qëndrueshme gjatë periudhës së analizuar, duke arritur në 29.4% në vitin 2024, nga 18.0% në vitin 2019 ose niveli më i lartë i regjistruar deri më tani.

Në linjë me gjetjet për të punësuarit, ku u analizua mënyra se si ata kishin gjetur punë, edhe në rastin e të papunëve vihet re se përdorimi i rrjetit informal (familjarë, miq, njohje) ka rënë ndjeshëm. Konkretisht, kjo mënyrë është përdorur nga 29.6% e të papunëve në vitin 2024, krahasuar me 44.9% në vitin 2019 dhe 38.1% në vitin 2023. **Ky trend sinjalizon një ulje të varësisë nga lidhjet personale dhe një orientim më i madh drejt kanaleve institucionale dhe formale të kërkimit të punës.**

Ndërkohë, **kontaktimi i drejtpërdrejtë me punëdhënësin** (p.sh. dërgimi i CV-së) ka shënuar një rritje të lehtë, duke arritur në 12.3% në vitin 2024, çka mund të interpretohet si **një rritje e proaktivitetit individual në aplikimin për vende pune.**

Tabela 22. Mënyrat e kërkimit të punës (2019-2024)

	2019	2021	2022	2023	2024
Nëpërmjet Zyrës së Punës	18.0%	19.2%	19.5%	24.7%	29.4%
Nëpërmjet lajmërimeve të publikuara në faqe interneti, media sociale etj.	28.1%	29.8%	24.1%	23.8%	27.8%

	2019	2021	2022	2023	2024
Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve	44.9%	45.6%	47.1%	38.1%	29.6%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim (duke dërguar CV etj.)	8.7%	4.4%	8.9%	12.2%	12.3%
Tjetër	0.3%	1.0%	0.4%	1.2%	0.80%

Të dhënat për të certifikuarit në 2024 tregojnë se arsyet personale dhe barrierat shëndetësore po zënë një vend gjithnjë e më të rëndësishëm në shpjegimin e mos angazhimit në kërkimin e punës nga personat joaktivë në tregun e punës. Dy arsye kryesore që raportohen janë: kujdesi për fëmijët apo familjen (21.3%) dhe problemet shëndetësore ose paaftësia (16.4%). Veçanërisht, kategoria "kujdesem për fëmijët/familjen" ka shënuar një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2023 (nga 10.7% në 21.3%) dhe rezulton në nivelin më të lartë të regjistruar gjatë gjithë periudhës 2019–2024, duke reflektuar rritje të barrës së përgjegjësive familjare si pengesë për përfshirjen në tregun e punës.

Ndërkohë, përqindja e atyre që presin të fillojnë punë së shpejti ka rënë në 16.4% në 2024, pas një piku të lartë në vitin 2023 (25.3%). Gjithashtu një tjetër tregues me rëndësi është rritja e pasigurisë në raport me mundësinë për të gjetur punë: 14.8% e personave joaktivë në vitin 2024 deklarojnë se nuk kanë besim se do të mund të punësohen, një rritje e ndjeshme krahasuar me 6.7% në vitin 2023. Nga ana tjetër, përqindja e atyre që planifikojnë të largohen nga vendi ka rënë ndjeshëm, nga 12.0% në vitin 2019 në vetëm 4.9% në vitin 2024.


Tabela 23. Arsyet që nuk kërkon punë (2019-2024)

	2019	2021	2022	2023	2024
Nga sëmundja ose paaftësia	5.2%	5.1%	0.0%	14.7%	16.4%
Kujdesem për fëmijët/familjen	10.9%	18.3%	9.1%	10.7%	21.3%
Po pres të filloj punë së shpejti	10.3%	12.3%	9.1%	25.3%	16.4%
Po pres për sezonin e përshtatshëm	10.7%	5.5%	27.3%	13.3%	4.9%
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	5.7%	1.7%	15.2%	4.0%	4.9%
Nuk kam besim se do të gjej një pune	21.0%	14.0%	11.1%	6.7%	14.8%
Kam një plan të largohem nga vendi	12.0%	15.3%	12.1%	5.3%	4.9%
Tjetër	24.2%	27.7%	16.2%	20.0%	16.4%

6.3 Marrëdhënia me zyrat e punës

Të dhënat për vitin 2024 tregojnë një rritje të ndjeshme të përqindjes së të papunëve të certifikuar që janë të regjistruar në zyrat e punës, duke arritur në 63.9%, niveli më i lartë gjatë periudhës 2019–2024. Ky zhvillim përfaqëson një rritje prej mbi 14 pikë përqindje krahasuar me vitin 2019 (49.9%) dhe 7.7 pikë përqindje më shumë se në vitin 2023 (56.2%).

Graf. 15 Regjistrimi në zyrat e punës për të papunët (2019-2024)



Të dhënat për vitin 2024 tregojnë një përmirësim të dukshëm në mbështetjen që të papunët e certifikuar marrin nga zyrat e punës, ku 64.3% prej tyre deklarojnë se kanë përfituar një formë ndihme. Mbështetja më e përhapur mbetet ofrimi i informacionit mbi vendet e lira të punës (38.7%), ndërsa ndihma nëpërmjet informacioneve mbi mundësitë e trajnimit (16.6%) dhe këshillave për kërkimin e punës (9.0%) kanë shënuar rritje të konsiderueshme krahasuar me periudhën 2019–2022.

Ndërkohë, përqindja e të papunëve që nuk kanë përfituar asnjë ndihmë nga zyrat e punës ka rënë ndjeshëm në 27.6% në vitin 2024, nga 34.8% në 2023 dhe 61.9% në 2022.

Tabela 24. Ndihma e zyrave të punës (2019-2024)

	2019	2021	2022	2023	2024
Me informacion mbi vendet e lira të punës	28.8%	27.2%	22.5%	36.1%	38.7%
Me informacion mbi mundësitë e trajnimit	3.8%	0.8%	4.6%	18.4%	16.6%
Me këshilla se si të kërkohet për punë	4.2%	1.5%	6.4%	6.3%	9.0%
Nuk po më ndihmon	58.5%	55.4%	61.9%	34.8%	27.6%
Tjetër	4.6%	15.1%	4.6%	4.4%	8.0%

Ndër të papunët që nuk janë të regjistruar në zyrat e punës, arsyet kryesore të mos regjistrimit në vitin 2024 lidhen me mungesën e interesit (32.5%) dhe mosbesimin në efektivitetin e këtyre institucioneve (37.7%). Një tjetër tregues është rritja e përqindjes së atyre që deklarojnë se nuk dinë si të regjistrohen nga 7.4% në vitin 2023 në 13.2% në vitin 2024. Kjo sugjeron nevojën për ndërhyrje më të forta informuese dhe orientuese.

Tabela 25. Arsyet e mos regjistrimit (2019-2024)


	2019	2021	2022	2023	2024
Nuk di si të regjistrohem	7.1%	12.3%	17.1%	7.4%	13.2%
Nuk besoj se do të më ndihmoj	33.9%	35.1%	29.0%	54.9%	37.7%
Nuk kam interes të regjistrohem	45.5%	24.7%	40.9%	32.0%	32.5%
Tjetër	13.5%	27.8%	13.0%	5.7%	16.7%

7. TË CERTIFIKUARIT JOAKTIV NË TREGUN E PUNËS

Të dhënat e studimit tregojnë se 24.4% e të certifikuarve janë të klasifikuar si joaktivë. Kjo kategori përfshin individë që nuk janë në punë dhe nuk janë duke kërkuar aktivisht punësim, shpesh për shkak të angazhimeve në studime, trajnime të mëtejshme, detyra familjare apo arsye të tjera personale. Shpërndarja gjinore e të certifikuarve inaktive tregon për diferenca të rëndësishme gjinore ku 30.4% e femrave të certifikuarve gjatë 2024 janë inaktive kundrejt 17.9% të meshkujve.


Shpërndarja e të certifikuarve joaktivë sipas qendrave tregon diferenca të qarta ndërmjet rajoneve. Përqindjet më të larta të joaktivitetit janë regjistruar në QFP Korçë (33.6%), Qendrën e Lëvizshme (32.8%) dhe QFP Fier (30.5%). Në të kundërt, përqindjet më të ulëta janë shënuar në QFP Nr.4 Tiranë (20.0%), QFP Vlorë (20.2%) dhe QFP Durrës (21.9%).

Graf. 16 Inaktivët sipas qendrave, 2024



Të dhënat për periudhën 2019–2024 tregojnë se pjesa më e madhe e të certifikuarve inaktivë nuk kanë arritur të punësohen asnjëherë pas përfundimit të kursit. Në vitin 2024, 78.7% e të anketuarve deklaruan se nuk kanë qenë të punësuar që nga përfundimi i trajnimit.

Graf. 17 Punësimi i mëparshëm për inaktivët (2019-2024)



7.1 Student/Kursant në trajnime të mëtejshme

Kategoria e të certifikuarve të cilët janë student apo kursant në trajnime të mëtejshme përbën rreth 6% të të certifikuarve për vitin 2024. Kjo kategori është përfshirë në personat inaktivë sipas statusit të punësimit. Sidoqoftë është me interes të shihet më në detaje disa aspekte që i përkasin vetëm kësaj kategorie. Njëra prej tyre është hulumtimi i arsyeve që i kanë shtyre për të ndjekur kurset e trajnimit profesional. Të dhënat për vitin 2024 tregojnë se arsyet kryesore për ndjekjen e kursit profesional nga të certifikuarit lidhen me dëshirën për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale (31.8%), që është në rritje krahasuar me vitet e mëparshme, dhe shënon nivelin më të lartë në pesëvjeçarin e fundit. Së dyti lidhet me rritjen e mundësive për të gjetur një punë më të mirë (30.6%), që gjithashtu shënon rritje për të dytin vit nadhazi pas një periudhe rënieje të ndjeshme në vitet 2021–2022. Dhe e treta është fitimi i një kualifikimi më të lartë (35.7%), megjithëse kjo arsye ka rënë krahasuar me vitin 2022 (51.6%) ku shënoi dhe përqindjen më të lartë si kategori.

Tabela 26. Arsyet e ndjekjes së kursit (2019-2024)

	2019	2021	2022	2023	2024
Për të fituar një kualifikim më të lartë	36.5%	40.8%	51.6%	38.1%	35.7%
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	42.5%	21.1%	18.8%	28.7%	30.6%
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	18.2%	37.1%	26.6%	28.7%	31.8%
Nuk po gjeja dot punë			0.5%	0.0%	0.6%
Tjetër	2.8%	0.9%	2.6%	4.4%	1.3%


Universiteti mbetet zgjedhja dominuese për të certifikuarit që ndodhen në trajnim apo janë ende studentë, me 86.3% të tyre që ndjekin një program universitar. Në krahasim, vetëm 3.1% ndjekin kurse pranë Qendrave të Formimit Profesional. Gjithashtu, 10.6% kanë deklaruar kategori të tjera, ndër të cilat 1.9% ndjekin arsim profesional pas të mesmes.

Tabela 27. Institucioni arsimor i studimit (2019-2024)

	2019	2021	2022	2023	2024
Universitet	88.5%	73.1%	71.3%	82.2%	86.3%
Qendër e Formimit Profesional	7.7%	5.0%	6.7%	8.6%	3.1%
Tjetër	3.8%	21.9%	22.1%	9.2%	10.6%

Vetëm 24.4% e të certifikuarve që janë aktualisht në studime apo trajnime ndjekin një program që lidhet me kursin e përfunduar më parë, ndërsa 75.6% ndjekin studime pa lidhje me të. Edhe pse kjo përqindje është rritur krahasuar me vitin 2023 (16.3%), është më e ulët se periudha 2021–2022.

Graf. 18 Lidhja e studimeve me kursin (2019-2024)




8. VLERËSIMI RETROSPEKTIV I TË CERTIFIKUARVE

Ky seksion përqendrohet në analizimin e perceptimeve dhe vlerësimeve të të gjithë të certifikuarve lidhur me qendrat dhe kursin që kanë ndjekur. Ky shqyrtim është thelbësor për të identifikuar në detaje aspektet që kërkojnë përmirësim, bazuar në opinionet dhe përvojat e tyre.

Vlen të theksohet se në këtë seksion janë përfshirë përgjigjet e të gjithë të certifikuarve të anketuar, pa marrë parasysh statusin e tyre aktual në tregun e punës, i cili është trajtuar në seksionet e mëparshme.

Në vitin 2024, 76.8% e të certifikuarve deklarojnë se do ta rizgjidhnin kursin e ndjekur, ndërsa 23.2% nuk do ta bënin këtë zgjedhje

Graf. 19 Rizgjedhja e kursit (2019-2024)



Në vitin 2024, niveli më i lartë i rizgjedhjes së kursit është regjistruar në QFP Korçë (95.3%) dhe në Qendrën e Lëvizshme (93.2%), të cilat paraqesin edhe një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2023. QFP Elbasan ka shënuar përmirësimin më të madh, nga vetëm 49.9% në vitin 2023 në 90.0% në vitin 2024. Përkundrazi, disa qendra kanë pësuar rënie të dukshme, si QFP Shkodër (nga 69.8% në 90.1%) dhe QFP Gjirokastër (nga 58.8%, në 46.7%, që mbetet më poshtë niveleve të viteve të mëparshme).

Tabela 28. Përqindja e të certifikuarve të cilët do e rizgjidhnin kursin, sipas qendrave (2019-2024)


	2019	2021	2022	2023	2024
QFP Durrës	87.0%	93.1%	89.3%	80.5%	79.4%
QFP Elbasan	93.0%	70.5%	94.4%	49.9%	90.0%

	2019	2021	2022	2023	2024
QFP Fier	96.8%	81.2%	95.4%	56.3%	71.7%
QFP Gjirokastër	97.2%	96.5%	92.2%	46.7%	58.8%
QFP Korçë	79.8%	85.5%	98.2%	88.4%	95.3%
Qendra e Lëvizshme	98.7%	90.2%	96.6%	87.7%	93.2%
QFP Nr.1 Tiranë	53.9%	88.0%	97.7%	94.9%	71.7%
QFP Nr.4 Tiranë	80.0%	92.7%	99.5%	96.8%	79.4%
QFP Shkodër	94.5%	92.2%	96.9%	90.1%	69.8%
QFP Vlorë	95.6%	91.6%	90.0%	46.0%	70.1%

Të dhënat tregojnë se të certifikuarit e kanë vlerësuar në mënyrë shumë pozitive kursin e formimit profesional, me rezultate veçanërisht të larta për cilësinë e stafit pedagogjik dhe përmbajtjen mësimore. Aftësitë teorike dhe praktike të stafit (94.3%) si edhe metodat e mësimdhënies (94.0%) kanë marrë vlerësimet më të larta, duke dëshmuar profesionalizmin dhe efektivitetin e instruktorëve. Kurrikulat (92.8%), praktika në qendër (92.5%) dhe tekstet/materialiet e trajnimit (92.4%) janë gjithashtu shumë të vlerësuara, çka tregon një balancim të mirë midis përmbajtjes teorike dhe mbështetjes materiale. Ndërkohë, infrastruktura (88.2%) dhe praktika në biznes (85.5%) paraqesin rezultate më të ulëta krahasuar me aspektet didaktike, duke sinjalizuar nevojën për përmirësim të kushteve fizike dhe zgjerim të mundësive praktike jashtë qendrës.

Fushat më pak të vlerësuara mbeten këshillimi i karrierës (83.5%) dhe bashkëpunimi i qendrës si me zyrat e punës, ashtu edhe me bizneset (të dyja me 77.1%), duke treguar një hendek të dukshëm në lidhjen mes formimit profesional dhe kërkesave të tregut të punës.

Graf. 20 Vlerësimi i kursit profesional 2024



Të dhënat e analizuara për periudhën kohore 2019-2024 përforcojnë gjetjet e mësipërme, duke treguar se të certifikuarit e vlerësojnë përgjithësisht në nivele shumë të larta kursin e formimit profesional, sidomos për aspektet didaktike dhe cilësinë e stafit. Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës (94.3%) dhe metodat e mësimdhënies (94.0%) kanë marrë vlerësimet më të larta, duke dëshmuar profesionalizmin dhe efektivitetin e instruktorëve.

Edhe kurrikulat (92.8%), praktika në qendër (92.5%) dhe materialet e trajnimit (92.4%) rezultojnë të vlerësuara shumë pozitivisht, çka tregon një përpunje të mirë mes përmbajtjes teorike dhe mbështetjes praktike. Nga ana tjetër, infrastruktura (88.2%) dhe praktika në biznes (85.5%) kanë marrë nota disi më të ulëta, duke sinjalizuar nevojë për përmirësim të kushteve fizike dhe zgjerim të mundësive praktike jashtë qendrës.

Në krahasim me një vit më parë, bashkëpunimi i qendrës si me zyrat e punës, ashtu edhe me bizneset (të dyja me 77.1%) shënon rëniet më të theksuara krahasuar me fushat e tjera, duke dëshmuar se të certifikuarit kërkojnë përmirësime më shumë në drejtim të bashkëpunimit ndër-institucional dhe forcimit të lidhjes me tregun e punës, sesa në vetë procesin mësimor brenda qendrave.

Tabela 29. Vlerësimi i kursit të formimit profesional (2019-2020)

	2019	2021	2022	2023	2024
Bashkëpunimi i qendrës me zyrat e punës	73.5%	71.5%	89.1%	85.5%	77.1%
Bashkëpunimi i qendrës me bizneset	72.5%	75.6%	89.4%	87.5%	77.1%
Këshillimi i karrierës (p.sh. për të gjetur punë etj.)	74.0%	74.8%	89.9%	90.1%	83.5%
Praktika në biznes	75.9%	90.1%	91.8%	90.8%	85.5%
Praktika në qendër	79.2%	90.3%	92.4%	93.2%	92.5%
Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës	82.9%	93.1%	95.4%	95.5%	94.3%
Metodat/mënyrat e mësimdhënies	82.8%	92.8%	95.8%	94.7%	94.0%
Tekset dhe materialet e trajnimit	81.7%	89.9%	92.0%	93.0%	92.4%
Kurrikulat	82.4%	90.1%	93.0%	92.6%	92.8%
Infrastruktura (p.sh. klasat, laboratorët etj.)	81.2%	88.2%	87.4%	92.8%	88.2%

8.1 Orientimi dhe këshillimi i qendrave të formimit

Të dhënat për të certifikuarit e punësuarit tregojnë se në vitin 2024 mbështetja e qendrave ka qenë më e orientuar drejt udhëzimit dhe aftësimin personal, ndërsa ndërlidhja direkte me tregun e punës dhe kontaktet me punëdhënësit vijnë të jenë pika më e dobët. Rezultate këto të cilat përforcojnë dhe gjetjet e mësipërme për vlerësimin e kursit të kryer.

Orientimi dhe këshillimi për të gjetur punë ka qenë i fokusuar kryesisht në zhvillimin e aftësive për kërkimin dhe aplikimin për punë (28.7%) dhe në informimin mbi mundësitë e ndryshme të punësimit (43.2%). Megjithatë, ndihma për krijimin e kontakteve me

punëdhënës potencialë mbetet e kufizuar (11.7%), ndërsa 10% e të certifikuarve deklarojnë se përgjithësisht nuk janë ndihmuar. Një pjesë e vogël (6.3%) ka raportuar forma të tjera mbështetjeje.

Tabela 30. Orientimi dhe këshillimi për të gjetur punë

	2019	2021	2022	2023	2024
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	29.5%	5.0%	13.6%	25.4%	28.7%
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	27.8%	32.6%	28.0%	44.7%	43.2%
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	7.6%	5.3%	16.1%	18.1%	11.7%
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	41.6%	28.1%	31.6%	6.5%	10.0%
Tjetër	-	29.0%	10.7%	5.3%	6.3%

8.2 Pritshmëritë për të ardhmen e afërt

Për të certifikuarit në vitin 2024, pritshmëria kryesore për dy vitet e ardhshme mbetet punësimi, me 35.6%, megjithëse kjo përqindje është ulur krahasuar me vitin 2023, kur arriti në 42.5%. Interesi për gjetjen e një pune që lidhet me fushën e studimit apo trajnimit mbetet afërsisht në të njëjtat nivele, duke shënuar 17.9% në krahasim me 16.7% një vit më parë.

Vërehet një rritje e ndjeshme e ambicies për të hapur biznes, e cila ka shënuar 30.2%, nga 24.3% në vitin 2023. Në të njëjtën kohë, dëshira për emigrim jashtë vendit vazhdon të ulet, duke arritur në nivele minimale prej 6.8%, krahasuar me 7.2% të një viti më parë.

Pritshmëritë për vijimin e studimeve mbeten shumë të ulëta, në nivelin 2.8%, ndërsa migrimi brenda vendit konsiderohet thuajse i papërfillshëm, me 0.6%.

Tabela 31. Pritshmëritë brenda dy viteve të ardhshme (2019-2024)

	2021	2022	2023	2024
Të jem i/e punësuar	15.5%	27.5%	42.5%	35.6%
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit/trajnimit	21.7%	18.6%	16.7%	17.9%
Të vazhdoj punën time dhe të rritem në karrierë	-	2.4%	-	-
Të kem filluar biznesin tim	16.6%	18.6%	24.3%	30.2%
Të zgjeroj biznesin tim	-	6.8%	-	-
Të kem ndjekur studime të mëtejshme	5.0%	11.8%	2.3%	2.8%
Të kem emigruar jashtë vendit	16.6%	10.3%	7.2%	6.8%
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	0.20%	0.5%	1.1%	0.6%
Tjetër	24.4%	3.5%	5.8%	6.0%



9. KONKLUZIONE

Studimi kombëtar për gjurmimin e të certifikuarve nga qendrat e formimit profesional ka mbledhur të dhëna nga personat e certifikuar gjatë vitit 2024 në të gjithë vendin. Nga rreth 6,876 certifikuar gjatë vitit 2024 në studim morën pjesë rreth 2,671 me një pjesëmarrje rreth 38.8%. Shpërndarja gjinore e të intervistuarve është 51.9% femra dhe 48.1% janë meshkuj. Moshë mesatare e të intervistuarve është rreth 33.9 vjeç dhe gjashtë në dhjetë ose 60.6% e tyre janë me arsim të mesëm, të përgjithshëm ose profesional. Të dhënat e të intervistuarve janë të ngjashme me popullatën çka tregon përfaqësueshmërinë e tyre.

Rezultatet e studimit paraqiten sipas statusit të punësimit pas kursit (në momentin e intervistës) së të certifikuarve. Statusi i punësimit tregon se shkalla e punësimit të të certifikuarve është 63.5%; shkalla e papunësisë 12.1% dhe 24.4% janë inaktivë. Rezultatet e studimit me të certifikuarit e 2024 tregojnë për një rënie të nivelit të punësimit dhe një rritje të nivelit të papunësisë për të certifikuarit në krahasim me një vit më parë, ku 66.9% ishin të punësuar dhe 9.4% të papunë. Përkatësisht rënia e nivelit të punësimit të të certifikuarve në krahasim me vitin 2023 është me 3.4 pikë përqindje dhe rritja e nivelit të të papunëve është me 2.7 pikë përqindje. Të dhënat sipas gjinisë tregojnë se burrat kanë nivele më të larta të shkallës së punësimit në krahasim me gratë, përkatësisht 72.8% dhe 54.9%. Një diferencë e tillë është e ngjashme me studimet e mëparshme dhe në linjë me të dhënat zyrtare të punësimit.

Nga ana tjetër analiza sipas qendrave të formimit profesional tregon se qendrat me punësim më të lartë të të certifikuarve në vitin 2024, janë ajo e Durrësit me 73%; e Vlorës me 70.4%; dhe QFP Gjirokastrë: 69.7%. Nga ana tjetër qendrat me punësim më të ulët janë Qendra e Lëvizshme me 41.9% të të certifikuarve të punësuar; QFP Fier me 55.3% dhe QFP Korçë me 58.6% të certifikuarve të punësuar.

Situata e të punësuarve të certifikuar tregon se 62.7% e tyre kanë më shumë se 12 muaj në punën aktuale. Ky është një tregues në të njëjtin nivel në krahasim me vitin 2023 ku 62.9% të të punësuarve deklaruan se kishin më shumë se 12 muaj në punën aktuale. Kohëzgjatja në punësimin aktual është një tregues i rëndësishëm pasi dëshmon për një stabilitet më të madh të personave në tregun e punës, dhe në vendosjen e marrëdhënieve më të qëndrueshme midis punëdhënësit dhe punëmarrësit. Të dhënat sipas gjinisë tregojnë se 66.6% e të punësuarve meshkuj punojnë me një kohëzgjatje më shumë se 12 muaj kundrejt 58.5% të femrave. Të pyetur lidhur më sa të sigurt personat e punësuar e shihnin punën aktuale, rreth 63.6% e shohin punën si të sigurt ose shumë të sigurt.

Në studimin e fundit vihet re një rënie e ndjeshme e gjetjes së punës me anë të lidhjeve personale, 33.8% kundrejt 50.3% në vitin 2023. Ky ndryshim nënvizon një transformim në drejtim të një tregu pune më të hapur dhe meritokratik, ku aftësitë profesionale kanë filluar të zëvendësojnë lidhjet personale.

Gjithashtu një element tjetër i integritetit të tyre është niveli i të ardhurave të të punësuarve. Përqindja e të punësuarve me një nivel të ardhurash deri në 40.000 lek, që korrespondon me pagën minimale në vend është 5.8%. Kjo e dhënë përforcon trendin rënës të të certifikuarve në këtë kategori të ardhurash nga punë. Nga ana tjetër vihet re një trend të rritjes së përqindjes së të certifikuarve në nivele pagash në fashën 50-95 mijë lek. Ndryshimi i të ardhurave pas kursit, është një tregues tjetër i

rëndësishëm i cili në mënyrë indirekte tregon për ndikimin që kursi ka patur në nivelin e të ardhurave të personave pas zhvillimit të tij. Për të anketuarit e certifikuar në 2024 më shumë se gjysma e tyre, 55.5% tregojnë për një rritje të të ardhurave pas mbarimit të kursit në krahasim me një vit më parë, me një rritje 5.6 pikë përqindje.

Sipas të dhënave të studimit më të fundit, 50.2% e të punësuarve vlerësojnë se ka një lidhje me kursin e kryer dhe detyrat e tyre aktuale profesionale. Edhe pse ky tregues paraqet një ulje në krahasim me një vit më parë, tendenca e përgjithshme mbetet në rritje, duke treguar një përmirësim progresiv në përputhshmërinë e programeve të trajnimit profesional me kërkesat e tregut të punës.

Për të certifikuarit në vitin 2024, përdorimi i njohurive të fituara nga trajnimi në punën aktuale ka regjistruar një rënie prej 69.9% në vitin 2023 në 60.6%, megjithatë ky tregues mbetet dukshëm më i lartë në krahasim me të gjitha vitet e mëparshme para 2023, gjë që dëshmon se shumica e të certifikuarve vazhdojnë të aplikojnë në masë të konsiderueshme njohuritë e marra nga trajnimet. Nga ana tjetër, 31.9% e punësuarve raporton një mospërputhje midis trajnimit të kryer dhe detyrave të punës aktuale. Analiza sipas gjinisë e të punësuarve të certifikuar tregon se meshkujt i përdorin më shumë njohuritë e marra në trajnim në krahasim me të certifikuarat femra ku përqindja që deklaron se i përdor shumë ose jashtëzakonisht shumë është për meshkujt 63.9% dhe për femrat 56.5%.

Rreth 15.1% e të certifikuarve në vitin 2024 janë të vetëpunësuar. QFP Gjirokastrë (20.4%), QFP Shkodër (18.9%) dhe QFP Fier (18.8%) regjistrojnë përqindjet më të larta të të certifikuarve që janë të vetëpunësuar. Analiza tregon se 85.1% e të vetëpunësuarve zhvillojnë aktivitetin e tyre në fusha të lidhura drejtpërdrejt me trajnimin e përfituar, një tregues që shënon rritje prej 2.4 pikë përqindjeje krahasuar me vitin e kaluar. Ky zhvillim përforcon trendin pozitiv të vërejtur përgjatë periudhës 2019–2024, duke reflektuar një përmirësim të qëndrueshëm në lidhjen mes aftësive të fituara dhe aplikimit të tyre praktik në tregun e punës. Nga analiza sipas gjinisë, nuk evidentohen dallime domethënëse: si femrat (85.3%) ashtu edhe meshkujt (85%) kanë të njëjtin nivel të përfshirjes në aktivitete të vetëpunësimit të lidhura me fushën e trajnimit, duke sugjeruar se efektiviteti i programeve të formimit është i barabartë për të dy gjinitë.

Punësimi sipas kursit të përfunduar tregojnë se ata që kanë përfunduar kurse si axhusteri mekanik, hekurkthim, punime ndërtimi, shërbime në bare/restorante, përpunim peshku, menaxhim hoteli kanë një integrim të plotë në tregun e punës me një punësim 100%. Gjithashtu dhe të certifikuarit në shërbimeve personale si berber, parukeri, manikyr/pedikyr, estetikë kanë përqindje punësimi mbi 50%.

Për të certifikuarit në vitin 2024, shkalla e papunësisë për të certifikuarit nga qendrat e formimit profesional arriti në 12.1%. Gjatë periudhës 2019–2024, vihet re një trend i përgjithshëm rënës i përqindjes së të papunëve pas përfundimit të trajnimeve profesionale, megjithëse ky tregues shënoi një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2023.

Të dhënat tregojnë shpërndarje të pabarabartë të nivelit të papunësisë mes qendrave të trajnimit profesional. Qendra e Lëvizshme (25.3%), QFP Tiranë Nr.1 (15.8%) dhe QFP Fier (30.7%) regjistrojnë përqindjet më të larta të të certifikuarve të papunë. Në të kundërt, performanca më e mirë vihet re në QFP Durrës (5.1%), QFP Gjirokastrë (7.7%) dhe QFP Korçë (7.8%), të cilat shfaqin nivele dukshëm më të ulëta të papunësisë.

Studimi i vitit të fundit, në përputhje me gjetjet e mëparshme, tregon se shumica e të papunëve nuk kanë pasur përvojë të mëparshme pune. Më konkretisht, 74.1% e tyre nuk kanë punuar kurrë më parë, ndërsa vetëm 25.9% kanë patur një punë para

ndjekjes së kursit. Analiza sipas gjinisë tregon se burrat e papunë kanë përqindje më të lartë të përvojës së mëparshme në punë (40.9%) krahasuar me gratë (34.6%).

Një tregues tjetër me rëndësi është rritja e ndjeshme e përqindjes së të papunëve të certifikuar të regjistruar në zyrat e punës. Në vitin 2024, ky nivel është në 63.9%, që përfaqëson jo vetëm vlerën më të lartë gjatë periudhës 2019–2024, por edhe një rritje prej mbi 14 pikë përqindje krahasuar me vitin 2019 (49.9%) dhe 7.7 pikë përqindje më shumë se në vitin 2023 (56.2%). Ky zhvillim sinjalizon një orientim në rritje të të papunëve drejt përdorimit të kanaleve formale dhe institucionale të ndërmjetësimit në punësim.

Gjithashtu të dhënat tregojnë një rritje të qëndrueshme të përdorimit të Zyrës së Punës si një mënyrë për të gjetur punë, duke arritur në 29.4%, nga 18.0% në vitin 2019, niveli më i lartë i regjistruar deri më sot. Në përputhje me gjetjet për të punësuarit, ku u analizua mënyra e sigurimit të vendit të punës, edhe për të papunët vihet re një rënie e dukshme e përdorimit të rrjeteve informale (familjarë, miq, njohje). Kjo formë është përdorur nga vetëm 29.6% e të papunëve të certifikuar në 2024, krahasuar me 44.9% në vitin 2019 dhe 38.1% në vitin 2023. Ky trend sinjalizon një ulje të varësisë nga lidhjet personale dhe një orientim më të fortë drejt kanaleve institucionale dhe formale të kërkimit të punës.

Vlerësimi i programeve të formimit profesional ngatë certifikuarit mbetet përgjithësisht shumë pozitiv. Në vitin 2024, 76.8% e tyre deklarojnë se do ta rizgjidhnin kursin e ndjekur, ndërsa 23.2% nuk do të bënin të njëjtën zgjedhje. Rezultatet janë veçanërisht të larta për cilësinë e stafit pedagogjik dhe përmbajtjen mësimore: aftësitë teorike dhe praktike të instruktorëve janë vlerësuar me 94.3%, metodat e mësimdhënies me 94.0%, kurrikulat me 92.8%, praktikat në qendër me 92.5% dhe materialet mësimore me 92.4%. Këto të dhëna tregojnë për një balancim të mirë midis përmbajtjes teorike dhe mbështetjes materiale.

Megjithatë, disa elementë paraqiten më dobët në vlerësim. Infrastruktura (88.2%) dhe praktika në biznes (85.5%) mbeten më poshtë krahasuar me aspektet didaktike, duke sinjalizuar nevojën për përmirësim të kushteve fizike dhe zgjerim të mundësive praktike jashtë qendrës. Po ashtu, këshillimi i karrierës (83.5%) dhe bashkëpunimi i qendrave me zyrat e punës dhe bizneset (të dyja me 77.1%) paraqesin boshllëqe të dukshme, që kufizojnë lidhjen efektive midis formimit profesional dhe kërkesave të tregut të punës.

Sa u përket pritshmërive për të ardhmen, pjesa më e madhe e të certifikuarve (35.6%) shprehin se prioriteti i tyre për dy vitet e ardhshme mbetet punësimi, ndonëse kjo përqindje ka rënë nga 42.5% në vitin 2023. Interesi për punësim në një fushë të lidhur me studimet ose trajnimin është pothuajse i pandryshuar (17.9% në vitin 2024 kundrejt 16.7% në vitin 2023). Vërehet gjithashtu një rritje e ndjeshme e ambicies për të hapur biznes, që ka arritur në 30.2% nga 24.3% një vit më parë. Në të kundërt, dëshina për të emigruar jashtë vendit ka vijuar të ulet, duke arritur në nivelin më të ulët prej 6.8%, krahasuar me 7.2% në vitin 2023.

Aneks: Rezultatet sipas qendrave

Tab. 1 Kohëzgjatja në punën aktuale sipas qendrave

	Më pak se 1 muaj	1 -3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 9 muaj	9-12 muaj	Mbi 12 muaj
QFP Durrës	1.3%	4.7%	3.4%	20.8%	5.4%	64.4%
QFP Elbasan		4.1%	3.3%	9.1%	5.8%	77.7%
QFP Fier	2.9%	5.8%	7.2%	14.5%	5.8%	63.8%
QFP Gjirokastër	2.0%	3.0%	5.0%	9.9%	15.8%	64.4%
QFP Korçë	3.7%	3.7%	7.4%	1.9%	16.7%	66.7%
QFP Nr.1 Tiranë	1.8%	5.9%	7.8%	12.8%	14.6%	57.1%
QFP Nr.4 Tiranë	1.4%	4.1%	8.6%	13.6%	8.6%	63.8%
QFP Shkodër	3.4%	6.0%	11.1%	14.5%	8.5%	56.4%
QFP Vlorë	5.7%	8.6%	6.4%	12.9%	7.1%	59.3%
Qendra e Lëvizshme	1.8%	7.0%	8.8%	12.3%	14.0%	56.1%

Tab. 2 Lloji i punësimit sipas qendrave të formimit

	Po, punoj me kohë të plotë	Jo, punoj me kohë të pjesshme
QFP Durrës	95.3%	4.7%
QFP Elbasan	99.1%	0.9%
QFP Fier	94.1%	5.9%
QFP Gjirokastër	93.0%	7.0%
QFP Korçë	92.7%	7.3%
QFP Nr.1 Tiranë	92.1%	7.9%
QFP Nr.4 Tiranë	95.9%	4.1%
QFP Shkodër	92.2%	7.8%
QFP Vlorë	93.5%	6.5%
Qendra e Lëvizshme	91.4%	8.6%

Tab. 3 Madhësia e subjektit sipas qendrave të formimit

	Ndërmarrje Mikro (1-9 të punësuar)	Ndërmarrje e Vogël (10-49 të punësuar)	Ndërmarrje e Mesme (50-249 të punësuar)	Ndërmarrje e Madhe (250+ të punësuar)
QFP Durrës	42.7%	40.7%	12.7%	4.0%
QFP Elbasan	54.2%	30.0%	14.2%	1.7%
QFP Fier	30.9%	41.2%	19.1%	8.8%

	Ndërmarrje Mikro (1-9 të punësuar)	Ndërmarrje e Vogël (10-49 të punësuar)	Ndërmarrje e Mesme (50-249 të punësuar)	Ndërmarrje e Madhe (250+ të punësuar)
QFP Gjirokastrë	48.5%	36.6%	11.9%	3.0%
QFP Korçë	37.0%	38.9%	20.4%	3.7%
QFP Nr.1 Tiranë	46.3%	27.8%	17.6%	8.3%
QFP Nr.4 Tiranë	39.4%	36.7%	20.2%	3.7%
QFP Shkodër	47.8%	40.9%	10.4%	0.9%
QFP Vlorë	43.4%	36.8%	14.7%	5.1%
Qendra e Lëvizshme	53.4%	32.8%	12.1%	1.7%

Tab. 4 Ndryshime në të ardhurat sipas qendrave të formimit

	Janë rritur	Janë ulur	Nuk kanë ndryshuar
QFP Durrës	58.9%		41.1%
QFP Elbasan	47.9%		52.1%
QFP Fier	58.8%		41.2%
QFP Gjirokastrë	45.0%	2.0%	53.0%
QFP Korçë	60.0%	1.8%	38.2%
QFP Nr.1 Tiranë	53.5%		46.5%
QFP Nr.4 Tiranë	59.7%	1.4%	38.9%
QFP Shkodër	54.9%		45.1%
QFP Vlorë	55.5%	0.7%	43.8%
Qendra e Lëvizshme	65.5%	1.7%	32.8%

Tab. 5 Qëndrueshmëria në punë sipas qendrave të formimit

	Shumë i/e pasigurt	I/e pasigurt	As i sigurt as i pasigurt/ neutral	I/e sigurt	Shumë i/e sigurt
QFP Durrës		3.3%	40.0%	38.7%	18.0%
QFP Elbasan	3.3%	5.8%	35.5%	41.3%	14.0%
QFP Fier		8.8%	47.1%	38.2%	5.9%
QFP Gjirokastrë	2.0%	2.0%	32.4%	54.9%	8.8%
QFP Korçë	1.8%	5.5%	30.9%	49.1%	12.7%
QFP Nr.1 Tiranë	0.9%	4.6%	40.3%	41.2%	13.0%
QFP Nr.4 Tiranë	1.4%	5.0%	27.3%	49.1%	17.3%
QFP Shkodër	1.7%	3.4%	29.3%	56.0%	9.5%
QFP Vlorë		2.9%	37.1%	48.6%	11.4%
Qendra e Lëvizshme	1.8%	1.8%	24.6%	56.1%	15.8%

Tab. 6 Vlerësimi për infrastrukturën sipas qendrave

	Aspak dhe Pak	Mesatarisht	Shume dhe Jashtëzakonisht Shume
QFP Durrës	1.1%	6.4%	92.5%
QFP Elbasan	1.1%	4.1%	94.8%
QFP Fier	3.2%	12.3%	84.5%
QFP Gjirokastër	0.5%	15.3%	84.2%
QFP Korçë	0.8%	8.6%	90.6%
QFP Nr.1 Tiranë	2.6%	18.8%	78.6%
QFP Nr.4 Tiranë	2.3%	3.8%	93.8%
QFP Shkodër	2.7%	5.5%	91.8%
QFP Vlorë	3.6%	14.3%	82.1%
Qendra e Lëvizshme	1.1%	4.0%	94.9%

Tab. 7 Vlerësimi për kurrikulën sipas qendrave

	Aspak dhe Pak	Mesatarisht	Shume dhe Jashtëzakonisht Shume
QFP Durrës	1.1%	6.7%	92.1%
QFP Elbasan	1.1%	4.1%	94.8%
QFP Fier	3.2%	11.8%	84.9%
QFP Gjirokastër	0.5%	5.9%	93.6%
QFP Korçë	1.6%	7.0%	91.4%
QFP Nr.1 Tiranë	0.9%	6.4%	92.7%
QFP Nr.4 Tiranë	0.8%	3.3%	95.9%
QFP Shkodër	2.8%	4.4%	92.9%
QFP Vlorë	2.4%	6.5%	91.1%
Qendra e Lëvizshme	1.1%	4.0%	94.8%

Tab. 8 Vlerësimi për tekstet dhe materialet e trajnimit sipas qendrave

	Aspak dhe Pak	Mesatarisht	Shume dhe Jashtëzakonisht Shume
QFP Durrës	1.1%	7.9%	91.0%
QFP Elbasan	1.5%	4.1%	94.4%
QFP Fier	1.6%	12.8%	85.6%
QFP Gjirokastër	1.0%	6.3%	92.8%
QFP Korçë	1.6%	8.6%	89.8%
QFP Nr.1 Tiranë	1.3%	5.5%	93.2%
QFP Nr.4 Tiranë	0.8%	4.4%	94.8%
QFP Shkodër	3.1%	3.9%	92.9%
QFP Vlorë	1.6%	6.9%	91.5%
Qendra e Lëvizshme	0.6%	6.8%	92.6%

Tab. 9 Vlerësimi për metodat/mënyrat e mësimdhënies sipas qendrave

	Aspak dhe Pak	Mesatarisht	Shume dhe Jashtëzakonisht Shume
QFP Durrës	1.1%	5.6%	93.2%
QFP Elbasan	1.1%	3.7%	95.2%
QFP Fier	1.1%	11.2%	87.7%
QFP Gjirokastrë	1.0%	4.3%	94.7%
QFP Korçë	1.6%	4.7%	93.8%
QFP Nr.1 Tiranë	0.4%	3.7%	95.8%
QFP Nr.4 Tiranë	1.3%	3.6%	95.1%
QFP Shkodër	3.1%	4.7%	92.2%
QFP Vlorë	1.6%	5.6%	92.8%
Qendra e Lëvizshme	0.6%	2.3%	97.2%

Tab. 10 Vlerësimi për aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës sipas qendrave

	Aspak dhe Pak	Mesatarisht	Shume dhe Jashtëzakonisht Shume
QFP Durrës	1.1%	5.3%	93.6%
QFP Elbasan	1.5%	4.8%	93.7%
QFP Fier	1.6%	10.2%	88.2%
QFP Gjirokastrë	0.5%	3.8%	95.7%
QFP Korçë	0.8%	3.9%	95.3%
QFP Nr.1 Tiranë	1.1%	3.5%	95.4%
QFP Nr.4 Tiranë	1.3%	2.1%	96.7%
QFP Shkodër	2.4%	5.9%	91.7%
QFP Vlorë	1.6%	4.8%	93.6%
Qendra e Lëvizshme	0.6%	2.3%	97.2%

Tab. 11 Vlerësimi për praktikatat në qendër sipas qendrave

	Aspak dhe Pak	Mesatarisht	Shume dhe Jashtëzakonisht Shume
QFP Durrës	1.5%	4.9%	93.6%
QFP Elbasan	2.6%	4.8%	92.6%
QFP Fier	3.2%	9.7%	87.0%
QFP Gjirokastrë	1.0%	5.9%	93.1%
QFP Korçë	1.6%	7.0%	91.4%
QFP Nr.1 Tiranë	2.6%	3.5%	93.8%
QFP Nr.4 Tiranë	2.1%	3.4%	94.6%
QFP Shkodër	3.2%	5.2%	91.6%
QFP Vlorë	1.6%	8.9%	89.5%
Qendra e Lëvizshme	1.7%	4.0%	94.3%

Tab. 12 Vlerësimi për praktikat në biznes sipas qendrave

	Aspak dhe Pak	Mesatarisht	Shume dhe Jashtëzakonisht Shume
QFP Durrës	2.3%	5.7%	92.1%
QFP Elbasan	3.0%	6.7%	90.3%
QFP Fier	3.8%	11.4%	84.8%
QFP Gjirokastrë	2.9%	16.5%	80.6%
QFP Korçë	7.0%	6.3%	86.7%
QFP Nr.1 Tiranë	11.9%	11.9%	76.2%
QFP Nr.4 Tiranë	2.8%	5.1%	92.0%
QFP Shkodër	5.1%	5.5%	89.3%
QFP Vlorë	10.0%	9.6%	80.3%
Qendra e Lëvizshme	6.8%	7.4%	85.8%

Tab. 13 Vlerësimi për këshillimin e karrierës (p.sh. për të gjetur punë etj.) sipas qendrave

	Aspak dhe Pak	Mesatarisht	Shume dhe Jashtëzakonisht Shume
QFP Durrës	2.6%	5.6%	91.7%
QFP Elbasan	3.3%	7.8%	88.8%
QFP Fier	5.4%	12.9%	81.7%
QFP Gjirokastrë	5.7%	16.3%	78.0%
QFP Korçë	6.3%	6.3%	87.5%
QFP Nr.1 Tiranë	14.3%	8.2%	77.5%
QFP Nr.4 Tiranë	2.3%	8.2%	89.4%
QFP Shkodër	3.9%	13.8%	82.3%
QFP Vlorë	12.0%	10.4%	77.5%
Qendra e Lëvizshme	6.3%	13.2%	80.5%

Tab. 14 Vlerësimi për bashkëpunimin e qendrës me bizneset

	Aspak dhe Pak	Mesatarisht	Shume dhe Jashtëzakonisht Shume
QFP Durrës	2.7%	12.9%	84.5%
QFP Elbasan	3.7%	7.8%	88.5%
QFP Fier	12.9%	15.1%	72.0%
QFP Gjirokastrë	10.6%	26.1%	63.3%
QFP Korçë	7.0%	8.6%	84.4%
QFP Nr.1 Tiranë	17.4%	9.9%	72.7%
QFP Nr.4 Tiranë	3.4%	11.4%	85.2%
QFP Shkodër	8.7%	20.1%	71.3%

QFP Vlorë	16.4%	14.4%	69.2%
Qendra e Lëvizshme	8.5%	13.6%	77.8%

Tab. 15 Vlerësimi për bashkëpunimin e qendrës me zyrat e punës

	Aspak dhe Pak	Mesatarisht	Shume dhe Jashtëzakonisht Shume
QFP Durrës	3.4%	12.5%	84.2%
QFP Elbasan	2.2%	8.2%	89.6%
QFP Fier	12.8%	15.5%	71.7%
QFP Gjirokastrë	11.1%	26.1%	62.8%
QFP Korçë	7.0%	8.6%	84.4%
QFP Nr.1 Tiranë	16.8%	10.0%	73.2%
QFP Nr.4 Tiranë	3.6%	10.3%	86.0%
QFP Shkodër	9.5%	20.2%	70.2%
QFP Vlorë	16.5%	14.5%	69.1%
Qendra e Lëvizshme	9.0%	14.7%	76.3%

Tab. 16 Statusi i punësimit sipas kursit të ndjekur

	Punësuar	Pa Punë	Inaktiv
Administrator ndërtesash	75.0%	15.0%	10.0%
Arkivë/protokoll	66.7%	0.0%	33.3%
Automekanikë	78.6%	7.1%	14.3%
Axhusteri Mekanike	100.0%	0.0%	0.0%
Berber	71.3%	8.4%	20.3%
Bojatisje	81.8%	0.0%	18.2%
Estetike	65.1%	12.0%	22.9%
Frutikulturë	0.0%	0.0%	100.0%
Graphic Design	45.7%	9.6%	44.7%
Hekurkthim	100.0%	0.0%	0.0%
Hekurpunim	80.0%	0.0%	20.0%
Instalim dhe mirëmbajtje e paneleve diellore	100.0%	0.0%	0.0%
Instalim dhe mirëmbajtje e rrjetit elektrik	74.1%	9.8%	16.1%
Instalim dhe mirëmbajtje e sistemeve ngrohëse-ftohëse	69.2%	15.4%	15.4%
Instalim dhe mirëmbajtje kondicioneresh	72.2%	5.6%	22.2%
Instalim i paneleve diellore fotovoltaike	85.7%	7.1%	7.1%
Instalime dhe mirëmbajtje hidraulike	71.8%	8.8%	19.4%
Gurghendja për punime restauruese guri	100.0%	0.0%	0.0%
Kopshtari	0.0%	22.2%	77.8%

	Punësuar	Pa Punë	Inaktiv
Kujdestar fëmijësh	63.51%	12.16%	24.32%
Kujdestar social	47.6%	26.2%	26.2%
Kujdestari për te moshuar	43.5%	43.5%	13.0%
Kujdestari për personat me aftësi të kufizuar	75.0%	0.0%	25.0%
Kuzhine	63.6%	9.9%	26.5%
Llamarinist dhe bojatisje automjetesh	62.5%	25.0%	12.5%
Manikyr Pedikyr	50.8%	15.0%	34.1%
Marketingu Digjital	33.3%	0.0%	66.7%
Menaxhim hoteli	100.0%	0.0%	0.0%
Mobilieri	75.0%	6.3%	18.8%
Modelim veshjesh për femra	16.7%	16.7%	66.7%
Montim dhe mirëmbajtje ashensori	77.8%	22.2%	0.0%
Ndihmës në Masazheri	60.0%	40.0%	0.0%
Operator Turistik	87.5%	12.5%	0.0%
Parukeri	48.2%	16.1%	35.7%
Pastigjeri	65.2%	10.9%	23.9%
Përpunim brumi/bukëpjekës	90.9%	9.1%	0.0%
Përpunim peshku	100.0%	0.0%	0.0%
Picajol	78.6%	3.6%	17.9%
Prodhime brumi	90.9%	9.1%	0.0%
Punime muratimi dhe suvatimi	44.4%	0.0%	55.6%
Punime ndërtimi	100.0%	0.0%	0.0%
Punime pllakashtrimi	91.7%	0.0%	8.3%
Qëndistari	0.0%	50.0%	50.0%
Reception	25.0%	25.0%	50.0%
Riparim aparaturash të thjeshta mjekësore	66.7%	16.7%	16.7%
Riparim i makinave qepëse	83.3%	8.3%	8.3%
Riparim kompjuteri	0.0%	0.0%	100.0%
Riparime elektroshtëpiake	69.2%	15.4%	15.4%
Rrobaqepësi	31.9%	13.9%	54.2%
Saldim	79.1%	7.0%	14.0%
Sekretari	66.0%	5.7%	28.3%
Servis elektroauto ne automjetet e lehta	78.6%	7.1%	14.3%
Servis motori ne automjetet e lehta	71.9%	14.1%	14.1%
Servis xhenerik në automjetet e lehta	75.0%	7.1%	17.9%
Shërbim pastrimi në njësi banimi dhe institucione	0.0%	66.7%	33.3%
Shërbime mikpritje hotelerie	71.4%	14.3%	14.3%
Shërbime ne Bare dhe Restorante	100.0%	0.0%	0.0%

	Punësuar	Pa Punë	Inaktiv
Shërbime ne bujtina	60.0%	40.0%	0.0%
Shërbime shitje	42.9%	14.3%	42.9%
Sipërmarrje dhe menaxhim i biznesit të vogël	69.9%	18.1%	12.0%
Sisteme të thata në ndërtesa	92.3%	0.0%	7.7%
Tipognafi	88.9%	0.0%	11.1%
Termohidraulikë	50.0%	16.7%	33.3%
Udhërrëfim turistik	90.0%	10.0%	0.0%
Web Design	54.2%	25.0%	20.8%
Total	63.5%	12.1%	24.4%

Tab.17 Të punësuar sipas statusit të punësimit para kursit, sipas qendrave

QFP	Statusi i punësimit para kursit	Niveli i punësimit pas kursit
QFP Durrës	I/E punësuar	96%
	Pa punë	57%
QFP Elbasan	I/E punësuar	85%
	Pa punë	38%
QFP Fier	I/E punësuar	86%
	Pa punë	37%
QFP Gjirokastrë	I/E punësuar	86%
	Pa punë	61%
QFP Korçë	I/E punësuar	90%
	Pa punë	49%
QFP Nr.1 Tiranë	I/E punësuar	85%
	Pa punë	46%
QFP Nr.4 Tiranë	I/E punësuar	88%
	Pa punë	54%
QFP Shkodër	I/E punësuar	91%
	Pa punë	57%
QFP Vlorë	I/E punësuar	93%
	Pa punë	51%
Qendra e Lëvizshme	I/E punësuar	89%
	Pa punë	36%

Tab.18 Statusi i punësimit për >22 vjeç, total

I/E punësuar	50,6%
I/E vetë-punësuar	16,4%
Punoj dhe studioj (ose trajnohem) në të njëjtën kohë	0,1%
Pa punë dhe po kërkoj për punë	11,6%
Pa punë por nuk kërkoj për punë	12,3%
Student/Kursant në trajnim të mëtejshëm	2,2%
Në paaftësi të përhershme	0,8%
Duke përmbushur detyrat shtëpiake (shtëpiak/e)	2,7%
Tjetër	2,0%
Languar jashtë vendit për punë	1,2%



TË CERTIFIKUARIT NGA **2024**
QENDRAT E FORMIMIT PROFESIONAL
GJURIMI NË NIVEL KOMBËTAR